



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 55

18 maj

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr. 24, datë 30.4.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.1341, datë 20.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; të vendimit nr.174, datë 21.3.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr.00-2010-321 (288), datë 18.3.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).....	2771
Vendim i GJK nr.25, datë 8.5.2012	Me objekt: 1. Shpalljen si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të neneve 3, 5, 6, 8 të ligjit nr. 10.449, datë 14.7.2011 “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë”. 2. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 10 449, datë 14.7.2011 “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë”.....	2776
Vendim i GJK nr. 26, datë 8.5.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimeve: nr.19, datë 7.5.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 50, datë 1.11.2007 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 394, datë 8.7.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	2790

VENDIM
Nr. 24, datë 30.4.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datë 31.1.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr. 59/34 Akti, që i përket:

KËRKUES: Bekim Murati, përfaqësuar nga avokat Aleksandër Prenga, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, e përfaqësuar me autorizim nga prokurori Artur Selmani.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr.1341, datë 20.11.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; i vendimit nr.174, datë 21.3.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr.00-2010-321 (288), datë 18.3.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 33, 42/1, 131/f, 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo; përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:
I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuar është akuzuar për veprën penale të “vjedhjes me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal (KP).

2. Sipas kërkesës të paraqitur nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga gjykatat është proceduar me gjykim të shkurtuar.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka bërë ndryshimin e cilësimit të veprës penale, me vendim nr.1341, datë 20.11.2007, ka vendosur, ndër të tjera, deklarimin fajtor të kërkuarit për veprën penale të “vjedhjes me pasojë vdekjen”, të kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë për sa i përket vjedhjes, parashikuar nga nenet 141, 25 dhe 22 të KP-së dhe e ka dënuar atë me 21 vjet burgim.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.174, datë 21.03.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2010-321 (288), datë 18.03.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi pasi ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

II

Pretendimet e palëve parashtruar Gjykatës Kushtetuese

6. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese, pasi këto vendime i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtimitet e mëposhtme:

6.1. *Është cenuar e drejta e mbrojtjes* sepse me ndryshimin e cilësimit të veprës penale nga ana e gjykatës, kërkuesit i është mohuar e drejta për t'u mbrojtur ndaj formulimit të ri të veprës penale.

6.2. *Është cenuar e drejta e për t'u vënë në dijeni për akuzën që i bëhet*, e sanksionuar nga neni 31/a i Kushtetutës pasi, me ndryshimin e cilësimit të veprës penale nga ana e gjykatës, kërkuesit nuk i është komunikuar akuza për veprën e re, të ndryshme nga ajo e paraqitur nga prokurori në kërkesën për gjykim.

6.3. *Janë cenuar të drejtat e parashikuara nga nenet 31 dhe 33 të Kushtetutës* për shkak se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka marrë masat që kërkuesi të jetë i pranishëm në të gjitha seancat gjyqësore. Gjatë seancës gjyqësore kërkuesi ka hequr dorë nga ky pretendim.

6.4. Mbrojtja e kërkuesit dhe e të pandehurit tjetër në gjykim, në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë është bërë nga i njëjti mbrojtës, edhe pse ata kanë deklaruar gjatë hetimeve në dëm të njëri – tjetrit. Avokati mbrojtës nuk mund të mbronte dy palë me interesa të kundërta në të njëjtën kohë. Gjatë seancës gjyqësore kërkuesi ka hequr dorë edhe nga ky pretendim.

7. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*, gjatë gjykimit, duke marrë parasysh edhe heqjen dorë nga kërkuesi, gjatë seancës gjyqësore, nga dy pretendimet e fundit, parashtrori në mënyrë të përmbledhur këto prapësime:

7.1. Kërkuesi ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 375 të KPP-së, pasi realizimi i të drejtës së mbrojtjes lidhet me detyrimin e organit të akuzës për të njohur kërkuesin me rrethin e fakteve të cilat do t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor. Ndërsa cilësimi ligjor i këtyre fakteve nga ana e organit të akuzës, qoftë edhe i gabuar, nuk e pengon kërkuesin që të realizojë të drejtën e mbrojtjes.

7.2. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjatë procedimit me gjykim të shkurtuar, duke bërë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, kanë vepruar konform jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese në lidhje me këtë institut.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

8. Gjykata Kushtetuese (në vijim "Gjykata"), duke marrë parasysh se kërkuesi ka hequr dorë, gjatë seancës gjyqësore, nga disa nga pretendimet e tij, çmon se në rastin objekt shqyrtimi, në thelb të pretendimeve të kërkuesit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor qëndron e drejta për t'u informuar për akuzën e ngritur dhe e drejta për t'u mbrojtur, prandaj, Gjykata në vijim do t'i japë përgjigje këtyre parimeve kushtetuese.

A. Në lidhje me pretendimin për cenimin e të drejtës për t'u informuar për akuzën dhe të drejtës së mbrojtjes

9. E drejta e individit për t'u vënë në dijeni menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, është sanksionuar nga neni 31/a i Kushtetutës dhe nga neni

6/3/a i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Ky parim kushtetues është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në funksion të realizimit të së drejtës së mbrojtjes të të akuzuarit si dhe të garantimit të parimit të barazisë së armëve ndërmjet palës akuzuese dhe mbrojtjes. Gjykata vëren se qëllimi i këtyre dispozitave është të krijojnë mundësinë për të akuzuarin të njihet paraprakisht me materialet, provat dhe rezultatet e hetimit, në mënyrë që të ushtrojë të drejtën e tij për të përgatitur një mbrojtje efektive, pra për të paraqitur argumentet në favor të tij dhe për të kundërshtuar akuzën e ngritur (*shih vendimin nr.4, datë 10.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në lidhje me të drejtën e mbrojtjes, Gjykata në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka theksuar se ajo duhet të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr.37, datë 19.09.2011; nr.25, datë 10.6.2011; nr.5, datë 17.2.2003 dhe nr.33, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në këtë këndvështrim, Gjykata, ka theksuar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, realizimi i mbrojtjes së të pandehurit, garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, përbëjnë në vetvete elementet më thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Për respektimin e këtyre parimeve, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të përmbushin një sërë detyrimesh, mes të cilave, sipas rastit, rëndësi të veçantë paraqet edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes, etj., me synimin që të realizohet një debat real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata (*shih vendimet nr.37, datë 19.9.2011; nr.25, datë 10.6.2011; nr.19, datë 18.9.2008; nr.13, datë 21.7.2008; nr.16, datë 8.6.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Po në këtë drejtim, qëllimi i së drejtës për t'u informuar për akuzën, i sanksionuar nga neni 6/3/a i KEDNJ-së, është që informacioni i kërkuar t'i jepet të akuzuarit në momentin e ngritjes së akuzës, ose në momentin e fillimit të procesit gjyqësor dhe është thelbësor fakti që vepra penale për të cilën dënohet një person, është ajo për të cilën ai është akuzuar (*shih vendimin nr.4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nga sa më lart, informimi i plotë dhe i saktë për akuzat e ngritura, si dhe për kualifikimin juridik të veprës penale, duhet të konsiderohet si kusht themelor për besueshmërinë e procesit dhe për përgatitjen e duhur të një mbrojtjeje efektive, e cila është një nga garancitë themelore për realizimin e të drejtës për një proces të rregull ligjor të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr.4, datë 10.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata çmon se, në çështjen në shqyrtim, në thelb të pretendimeve të kërkuesit për cenim të të drejtës për t'u informuar për akuzën e ngritur dhe të drejtës për t'u mbrojtur, qëndron e drejta e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale dhe për pasojë për të dënuar të pandehurin për një vepër të ndryshme më të rëndë, nga ajo për të cilën është akuzuar nga prokurori në kërkesën për gjykim, kur ndërkohë nga gjykata është proceduar me gjykim të shkurtuar.

15. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se gjykimi i shkurtuar, i parashikuar nga nenet 403-406 të KPP-së, ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton dhe shkurtton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen në një 1/3 e masës së dënimit dhe mosaplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm. Ky përfitim, nuk duhet kurrsesi të shkojë në dëm të dhënies të drejtësisë. Pra, kërkesën e të dënuarit dhe të mbrojtësit të posaçëm të tij, gjykata e pranon vetëm atëherë, kur ajo praktikisht bindet se mund të përfundojë çështjen në gjendjen që janë aktet, pa qenë nevoja për shqyrtimin gjyqësor.



16. Ndërsa në këndvështrimin kushtetues, Gjykata është shprehur se gjykimi i shkurtuar është një gjykim i posaçëm i cili konsiston në heqjen dorë në mënyrë të vullnetshme dhe eksplicite nga i pandehuri nga disa aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të tilla si parimi i barazisë së armëve dhe i formimit të provës në kontradiktoritet, në këmbim të një sërë avantazheve që atij i garantohen nga legjislati i brendshëm, pra për të përfituar një ulje dënimi. Por, që të merret në konsideratë kjo heqje dorë duhet të jetë e shprehur në mënyrë eksplicite dhe duhet të jetë e shoqëruar me një minimum garancish (*shih vendimin nr.4, datë 10.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në këtë aspekt, edhe GJEDNJ-ja ka çmuar gjithashtu se një i pandehur duhet të presë që Shteti të veprojë në mirëbesim dhe të ketë marrë mirë parasysh zgjedhjet procedurale të mbrojtjes, duke përdorur mundësitë e ofruara nga ligji. Është kundër parimeve të sigurisë juridike dhe të mbrojtjes të besimit legjitim të personave që janë në gjykim që Shteti mund, në mënyrë të njëanshme, të ulë avantazhet që rrjedhin nga heqja dorë e disa të drejtave që kanë të bëjnë me nocionin e procesit të rregullt. Nëse kjo heqje dorë bëhet në këmbim të avantazheve të lartpërmendura, nuk mund të konsiderohet e drejtë që, pasi autoritetet e brendshme kanë pranuar të procedojnë me gjykim të thjeshtuar, një element themelor i marrëveshjes ndërmjet Shtetit dhe të pandehurit mund të modifikohet në disavantazh të këtij të fundit, pa konsensusin e tij. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja ka vërejtur se, nëse është e vërtetë që Shtetet kontraktuese nuk janë të detyruar nga Konventa të parashikojnë procedura të thjeshtuara, qëndron gjithsesi fakti se, kur këto procedura ekzistojnë dhe aplikohen, parimet e procesit të rregullt ligjor imponojnë që të mos privohet në mënyrë arbitrare i pandehuri nga avantazhet që me atë procedurë lidhen (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr. 10249/03*).

18. Po në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se me kërkesën për gjykim të shkurtuar i pandehuri pranon të gjykohej me gjykimin e posaçëm në raport me akuzat e formuluar nga prokurori, e vetëm ndaj tyre ai shpreh vlerësimin e dobisë së këtij gjykimi; kështu që nuk do të ishte kushtetutshmërisht e pranueshme që ai të gjendej i detyruar nga zgjedhja e tij edhe ndaj veprave penale të reja (të ndryshme) që mund t'i ngarkoheshin. Me pasojën që kur akuza pëson një ndryshim substancial në disfavor të të pandehurit, ky i fundit duhet të rivendoset në afat për të bërë vlerësimet e duhura, me rrjedhojë, përndryshe, cenimin e të drejtës së mbrojtjes, si dhe të parimit të barazisë së armëve, duke qenë se do të kishim një diskriminim sipas mënyrës së vlerësimit diskrecional të rezultateve të hetimeve paraprake nga ana e prokurorit” (*shih vendimin nr.4, datë 10.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata, duke u bazuar në vlerësimet e lartpërmendura, vëren se kërkuesi, duke marrë në konsideratë kualifikimin e veprës penale të “vjedhjes me dhunë”, të kryer nga prokurori, si dhe duke vlerësuar dënimin e parashikuar për këtë vepër penale (në rast të deklarimit fajtor të tij nga gjykata), ka kërkuar të procedohet me gjykim të shkurtuar, në gjendjen që janë aktet, në lidhje me këtë vepër penale, duke hequr dorë kështu në mënyrë të vullnetshme nga disa të drejta kushtetuese (si parimi i barazisë së armëve dhe i formimit të provës në kontradiktoritet) në gjykim në mënyrë që të përfitojë nga avantazhet (ulja e dënimit) e përcaktuara nga legjislati për këtë qëllim; ndërsa gjykatat e juridiksionit të zakonshëm edhe pse kanë pranuar kërkesën e kërkuarit për të proceduar me gjykim të shkurtuar në lidhje me veprën penale të “vjedhjes me dhunë”, e kanë deklaruar fajtor dhe dënuar për një vepër penale të re, më të rëndë, atë të “vjedhjes me pasojë vdekjen” duke i cenuar kështu kërkuarit të drejtën e mbrojtjes në lidhje me veprën për të cilën është deklaruar fajtor.

B. Në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale

20. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale mund të aplikohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjatë gjykimit

të zakonshëm, vetëm kur zbatohen në mënyrë rigoroze kërkesat e përcaktuara nga vetë Gjykata, në mënyrë të veçantë në lidhje me garantimin e realizimit të së drejtës së mbrojtjes të palëve në gjykim ndaj formulimit të ri të veprës penale. “Zbatimi në këtë mënyrë i kërkesave të nenit 375 të KPP-së, është një garanci për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duke e vënë gjykatën në rol in që i takon për dhënien e drejtësisë” (shih vendimin nr.50, datë 30.07.1999 të Gjykatës Kushtetuese).

21. Institutin në fjalë, Gjykata, e ka shqyrtuar në funksion të garantimit të së drejtës së mbrojtjes të të akuzuarit. Ajo ka theksuar se e drejta të informohesh për natyrën dhe motivet e akuzës duhet të konsiderohet në këndvështrimin e të drejtës së të pandehurit të përgatitë mbrojtjen e tij. Nëse gjyqtarët e themelit disponojnë, kur kjo e drejtë i është njohur në të drejtën e brendshme, mundësinë për të rikualifikuar faktet, ata duhet të sigurohen që të pandehurit kanë pasur oportunitetin të ushtrorjnë të drejtën e tyre të mbrojtjes në mënyrë korrekte dhe efektive. Kjo do të thotë që të pandehurit duhet të informohen në kohë të përshtatshme jo vetëm me motivet e akuzës, pra me faktet materiale që i atribuohen dhe mbi të cilat bazohet akuza, por edhe, dhe në mënyrë të detajuar, me kualifikimin juridik të dhënë këtyre fakteve (shih vendimin nr.4, datë 10.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

22. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se, në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë duke bërë ndryshimin e cilësimit të veprës penale, pasi ka pranuar kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të shkurtuar, nuk ka respektuar kërkesat e përcaktuara nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e GJEDNJ-së në lidhje me këtë institut. Pra, gjykata e shkallës së parë nuk i ka dhënë mundësinë kërkuesit për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes ndaj veprës së re penale, për më tepër më të rëndë, në disfavor të tij. Duke shkruar më tej, Gjykata vëren se edhe gjykatat e shkallëve më të larta nuk kanë plotësuar apo korrigjuar mangësitë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor. Në këtë drejtim, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (shih vendimet nr.4, datë 28.2.2006 dhe nr.41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

23. Bazuar në këto vlerësime, Gjykata rithekson se gjyqtari në momentin e marrjes së vendimit, në lidhje me pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar të të pandehurit, duhet të udhëhiqet jo vetëm nga parimi i ekonomisë gjyqësore (shih paragrafin 15 të këtij vendimi), por duhet të vendosë, kryesisht, në përputhje me parimin e drejtësisë efektive. Kjo do të thotë që ai, ndër të tjera, duhet të marrë në konsideratë edhe cilësimin juridik të veprës penale të përcaktuar nga prokurori (shih vendimin nr.4, datë 10.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

24. Nisur nga kjo premisë, Gjykata çmon se nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, edhe në rastin kur procedohet me gjykim të shkurtuar, njësoj si në gjykimin e zakonshëm, do të mund të bëjnë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe të dënojnë të pandehurin për një vepër penale të ndryshme dhe me një masë dënimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori, instituti do të humbiste çfarëdolloj justifikimi kushtetues, për arsye se i pandehuri, duke hequr dore në mënyrë të vullnetshme nga disa parime kushtetuese si parimi i barazisë së armëve dhe nga parimi i kontradiktoritetit, do të sakrifikoje të drejtat e tij kushtetuese jo vetëm pa pasur asnjë lloj përfitimi, por edhe duke marrë një dënim më të lartë nga ai që priste (shih vendimin nr.4, datë 10.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

28. Nga sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se, kur nga gjykatat e juridiksionit të



zakonshëm procedohet me gjykim të shkurtuar ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale nga ana e gjykatës në disfavor të të pandehurit, është në kundërshtim me qëllimin e këtij gjykimi. Gjykata çmon se kërkuesi, në çështjen konkrete, edhe pse është proceduar me gjykim të shkurtuar, është dënuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për një veprë penale të re, më të rëndë nga ajo e përcaktuar nga prokurori në kërkesën për gjykim, pa pasur mundësinë për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes ndaj formulimit të ri të veprës penale.

29. Në vijim të arsytimit të mësipërm, Gjykata vlerëson, se në procesin e zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është cenuar e drejta e kërkuetit për t'u mbrojtur në procesin penal, si një nga elementët thelbësorë të procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.1341, datë 20.11.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimit nr.174, datë 21.3.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimit nr.00-2010-321 (288), datë 18.3.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi), vetëm për sa i përket të gjykuarit Bekim Murati.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Admir Thanza

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr.25, datë 8.5.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	Anëtare	e	“ “
Sokol Berberi	Anëtar	i	“ “
Fatmir Hoxha	Anëtar	i	“ “
Admir Thanza	Anëtar	i	“ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“ “
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“ “

me sekretare Enina Mullaj, në datë 23.11.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.48/23 Akti, që i përket:

KËRKUES: Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësuar nga Genc Çifligu dhe Artan Lame, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulëzim Lelçaj dhe Arjeta Cefa, me autorizim.

Këshilli i Ministrave të Republikës Së shqipërisë, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shpallja si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të neneve 3, 5, 6, 8 të ligjit nr. 10.449, datë 14.7.2011 “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë”.

2. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 10 449, datë 14.7.2011 “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 4, 7, 81/2, 131, shkronja “a” dhe 134/1, shkronja “c”;

Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, nenet 45, 49, 50, dhe 51.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesit e palës kërkuese që kërkuan pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 10 449, datë 14.7.2011 “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë”. Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave, të drejtat, detyrimet dhe afatet në dispozicion të institucioneve respektive për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar. Pala kërkuese, nëpërmjet kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkon shfuqizimin e neneve 3, 5, 6, 8 të këtij ligji, duke parashtruar këto argumente:

- Bazuar në nenin 134, pika 1 shkronja “c” të Kushtetutës, 1/5 e deputetëve ka legjitimitet të plotë të vërë në lëvizje procesin e kontrollit kushtetues, pasi në dallim nga subjektet e parashikuara në nënparagrafët “dh” deri “g” të nenit 134, të cilët “mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre”, Kushtetuta nuk ka parashikuar ndonjë kusht që nevojitet të plotësohet nga ana e këtij lloji subjekti. Gjithashtu, bazuar në nenin 131, shkronja “a” të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka juridiksion për të shqyrtuar çështjen e ngritur para saj.

- Është shkelur parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, sepse ligji objekt kundërshtimi, në aspekt të përcaktimit të pozicionit gjeografik/planvendosjes së objektit që do të ndërtohet, të përcaktimit të kompetencës së organit që do të japë lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit, të përcaktimit të organit që do të nxjerrë aktet nënligjore për ngritjen e kantierit të punimeve në sheshin e liruar të ndërtimit, ka dhunuar kompetencat e pushtetit vendor në fushën e planifikimit urban dhe të menaxhimit të territorit; këto kompetenca, sipas legjislationit në fuqi¹, i janë njohur pushtetit vendor si “funksione të veta” dhe

¹ Ligji nr.8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligj organik, i miratuar me shumicë të cilësuar, 3/5 e deputetëve të Kuvendit, parashikon (neni 10); ligji nr.8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën” (i ndryshuar, në fuqi deri në 30.09.2011), (nenet 14, 20 48); ligji nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit” (i ndryshuar), (nenet 59, 71, 72, 74)



ekskluzive. Për pasojë, në aspektet e mësipërme, është cenuar parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve në rrafshin vertikal, mes pushtetit qendror dhe atij lokal, si dhe parimi i decentralizimit dhe vetëqeverisjes lokale (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese 29/2006*).

- Është shkelur parimi i shtetit të së drejtës, sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, sepse rregullimi i nenit 3 të ligjit cenon “funksionet e veta” të pushtetit vendor dhe njëkohësisht edhe parimin e decentralizimit të pushtetit dhe të vetëqeverisjes lokale (të sanksionuar nga neni 13 i Kushtetutës), si edhe parimin e shtetit të së drejtës të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, në kundërshtim edhe me vendimin nr.29/2006 të Gjykatës Kushtetuese.

- Referuar faktit që godina që mendohet të priset nëpërmjet zbatimit të këtij ligji, ndodhet në zonën e shpallur Ansambël Monument Kulture të qendrës së qytetit të Tiranës, për shkak të veçantisë dhe papërsëritshmërisë që kanë monumentet e kulturës, prishja e kësaj godine-monument kulture bie ndesh me nenet 38, dhe 39 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” (të ndryshuar), si dhe me gjithë frymën e këtij ligji në përgjithësi dhe me nenet 3 dhe 59 të Kushtetutës.

- Është shkelur parimi i shtetit të së drejtës edhe përmes mosrespektimit të parimit të hierarkisë së akteve normative, sepse parashikimet ligjore të dispozitave të veçanta të këtij ligji, konkretisht parashikimet e neneve 2, 3, 5, në aspekt të planifikimit urban dhe menaxhimit të tokës, i janë mbivendosur parashikimeve të bëra në ligjin organik për pushtetin vendor, nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Në këtë mënyrë, është cenuar parimi kushtetues i hierarkisë së akteve normative, i sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, pasi me ligj të thjeshtë i janë hequr funksionet dhe autoriteti një pushteti që origjinalisht dhe tradicionalisht i ka fituar nëpërmjet një ligji të përforcuar.

- Është shkelur parimit i shtetit të së drejtës duke cenuar parimin e sigurisë juridike, sepse ligji objekt kundërshtimi, duke lënë të papërcaktuar vlerën e përgjithshme financiare të kompleksit të ri parlamentar, krijon mungesë të harmonizimit të dispozitave të tij me ato të ligjeve të tjera si dhe lejon hapësira të pakufizuara për shpërdorim të fondeve publike nga organet e shtetit, duke rënduar barrën e taksave dhe tatimeve që duhet të mbajë qytetari shqiptar. Si rrjedhojë e kësaj mangësie, janë shkelur urdhërimet kushtetuese të parashikuara nga nenet 82, pika 1 dhe 157, pika 4 të Kushtetutës për shkak se ligji objekt kundërshtimi, duke mos pasur të përfshirë vlerën financiare, shkel njëherazi edhe urdhërimet kushtetuese të parashikuara nga nenet 82, pika 1 dhe 157, pika 4 të Kushtetutës.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrou këto prapësime:

- Bazuar në vendimin nr.34, datë 8.4.2011 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sepse, referuar pretendimeve të parashtruara në kërkesë, kërkuesi kërkon zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor.

- Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Pjetër Arbërori” nuk gëzon statusin e monumentit të kulturës të kategorisë së dytë, sepse një status i tillë i është hequr nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me urdhrin nr. 610, datë 22.12.2010, të nxjerrë në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 24 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar);

- Ligji është në pajtim me Kushtetutën dhe nuk cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve mes pushtetit qendror dhe atij vendor si dhe parimin e decentralizimit dhe të

vetëqeverisjes vendore, pasi ky ligj bën thjesht rregullimin e procedurave për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar. Neni 3 i ligjit objekt kundërshtimi parashikon se “autoriteti shtetëror kompetent për dhënien e lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit është Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH) ose Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”. Parashikimi ligjor i këtij neni është në përputhje të plotë me nenin 3 pika 21/1, nenin 6 /a dhe me nenin 8/2/d (i, ii) të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit” (i ndryshuar), nene këto që përcaktojnë se cilat janë dhe çfarë përfshijnë “çështjet e rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit”, si dhe kompetencën e KKT-së, për miratimin e përcaktimit të rëndësisë kombëtare të një çështjeje në planifikimin e territorit, si dhe miratimin e kërkesave për zhvillim dhe leje ndërtimi në zonat kombëtare dhe në pronat shtetërore të patransferuara të njësisve të qeverisjes vendore;

- Ligji nuk cenon parimin e sigurisë juridike dhe urdhërimet kushtetuese të parashikuara nga nenet 82, pika 1 dhe 157, pika 4 të Kushtetutës, për shkak se nuk është shoqëruar me faturën financiare për zbatimin e tij. Vlera financiare e tij nuk është objekt i këtij ligji. Gjithashtu, dhe vetë Kushtetuta në nenin 82/1 të saj përcakton se propozimi i ligjeve “kur është rasti” duhet të shoqërohet me raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij, pra jo çdo ligj duhet të ketë raportin shoqëruar për shpenzimet financiare.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrroi këto prapësime:

- Ankimi i bërë është abuziv, për shkak se kërkuesi nuk e ka ushtruar efektivisht funksionin e deputetit gjatë procesit ligjvënës për këtë ligj para se t’i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e aktit. Kapërcimi procedural i grupit të 33 deputetëve menjëherë në Gjykatën Kushtetuese, pa ushtruar funksionin e ligjvënësit me votë pro ose kundër, tregon dukshëm natyrën abuzive të ankimit.

- Kërkuesi, edhe pse subjekt i pakushtëzuar, duhet të ketë një interes të ligjshëm për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Sjellja e kërkuarit gjatë procesit ligjvënës në kohën e shqyrtimit të ligjit në Kuvend tregon mungesën e interesit të ligjshëm në paraqitjen e kërkesës së tij, e cila për më tepër përbën edhe një abuzim me të drejtën e ankimit në Gjykatën Kushtetuese.

- Ligji i kundërshtuar nuk cenon parimet kushtetuese të decentralizimit dhe të autonomisë vendore, pasi është nxjerrë në përgjigje të nevojës kombëtare për të pasur një kompleks parlamentar, unik në llojin e tij, të një rëndësie të veçantë me natyrë mbarëkombëtare, realizimi i të cilit diktohet nga nevojat e pushtetit qendror për të siguruar përmbushjen e tij me efektivitet dhe në mënyrë ekonomike. Realizimi i kësaj vepre është marrë përsipër nga pushteti qendror me ligj, në të cilin përcaktohet me fjalë të qarta detyra që do të kryhet. Për më tepër, ky ligj respekton parimin e proporcionalitetit, sepse parashikon masa të përshtatshme për arritjen e qëllimit social, qëndrim që është përkrahur edhe nga Gjykata Kushtetuese në arsyetimin e vendimit të saj nr. 29 datë 21.12.2006. Pikërisht në këtë analizë nuk qëndron edhe pretendimi i kërkuarit se ligji objekt kundërshtimi shkel rregullimin kushtetues që detyron zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese;

- Parashikimet e këtij ligji nuk cenojnë planifikimin urban dhe menaxhimin e tokës, si funksione të veta të pushtetit vendor, të përcaktuara në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, sepse bazuar në dispozitat e këtij ligji organik, funksionet e veta ushtrohen “brenda hapësirës së normave, kritereve dhe standardeve të pranuar përgjithësisht me ligj” (pika 4 e nenit 2); “planifikimi urban, menaxhimi i tokës dhe strehimi realizohen sipas mënyrës së përcaktuar me ligj” (shkronja “g” e pikës 3 të nenit 10) dhe “kompetencat për kryerjen e funksioneve të veta, komuna dhe bashkia i ushtrojnë duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale” (pika 2 e nenit 10).

- Ligji nuk cenon parimin e sigurisë juridike, dhe urdhërimet kushtetuese të parashikuara nga nenet 82, pika 1 dhe 157, pika 4 të Kushtetutës, sepse i mungon fatura financiare për shkak se vlera financiare e tij nuk është objekt i këtij ligji dhe se shpenzimet e kësaj nisme ligjore i përkasin



buxhetit të Kuvendit dhe do t'i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik. Po kështu, bazuar në këto parashikime kushtetuese, raporti i shpenzimeve financiare nuk përbën kusht *sine qua non* me pasojë pavlefshmërinë kushtetuese të aktit normativ, pasi i shërben dijenisë së deputetëve që këta të fundit të kenë mundësinë për të vlerësuar mundësitë e financave publike për efektivitetin e nismës së ndërmarrë. Vetë ligji përmban rregulla me natyrë procedurale me kosto financiare 0 lekë, pasi nuk prish dhe as ndërton ndonjë ndërtesë si dhe përbush kushtin e marrjes së mendimit të Këshillit të Ministrave, pasi është tërhequr mendimi i Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit si dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

II

Mbi legjitimitimin e kërkuarit

Gjykata Kushtetuese (Gjykata), duke iu referuar pretendimit kryesor të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, lidhur me moslegjitimitimin e kërkuarit, e sheh me vend të shprehet fillimisht për këtë çështje.

Gjykata vlerëson se pretendimi i subjekteve të interesuara për moslegjitimitimin e kërkuarit është i bazuar dhe duhet pranuar.

Gjykata, duke iu referuar natyrës dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara gjatë gjykimit, vëren se kërkuari kërkon zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet një organi të pushtetit qendror, Kuvendit të Shqipërisë dhe një organi të qeverisjes vendore, Bashkisë Tiranë.

Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme, Gjykata ka theksuar se konflikti i kompetencave mund të ekzistojë nëse dy organe/pushtete pretendojnë ushtrimin e të njëjtës kompetencë, ose kur asnjëri prej dy organeve/pushteteve nuk merr përsipër ushtrimin e një kompetence (*vendime të Gjykatës Kushtetuese nr.26/2006, nr.20/2007; nr.12/2008*). Nisur nga ky qëndrim, mosmarrëveshja e kompetencës mund të shtrohet në dy plane; njëri plan lidhet me rastin kur objekt i mosmarrëveshjes është ndërhyrja me akt normativ në kompetencat e një organi kushtetues, duke sjellë si pasojë pakësimin ose shtimin e kompetencave të tij. Në këtë rast, objekt i mirëfilltë i gjykimit kushtetues është vlerësimi *in abstracto* nëse ky ndryshim i kompetencave ka cenuar parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve, pasi balancimi midis pushteteve ka ndryshuar. Një plan tjetër është rasti kur konflikti i mirëfilltë i kompetencave lidhet me faktin kur një apo disa organe nxjerrin akte që cenojnë sferën e kompetencave të njëra-tjetrës. Në këtë rast, objekt i mirëfilltë i gjykimit kushtetues është vlerësimi *in concreto* nëse akti ka prekur kompetencat e një organi tjetër.

Në bazë të nenit 54, pika 3 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", ndërmjet të tjerash, që të iniciohet një çështje për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje kompetencash midis pushteteve përpara kësaj Gjykate, kërkesa duhet të ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti. Në rastin në shqyrtim, duke pasur parasysh pretendimet e kërkuarit, Gjykata vlerëson se kërkuari nuk është as subjekt në konflikt e as subjekt i cenuar drejtpërdrejt nga konflikti. Në rastin konkret, grupi i deputetëve është përqendruar në mbrojtjen e sferës së veprimtarisë së pushtetit vendor dhe jo të të drejtave të veta si pakicë parlamentare. Situata ku ndodhet kërkuari nuk e legjitimon atë të kërkojë nga kjo Gjykatë zgjidhjen e një konflikti të mundshëm kompetencash. Kërkuari duhet të paraqiste argumente që të provonin pretendimin se moszgjidhja ose ekzistenca e këtij konflikti ka sjellë mosfunksionimin ose pengimin e funksionimit normal të Kuvendit, pjesë e të cilit është kërkuari, duke cenuar statusin e tij dhe rrjedhimisht ushtrimin e të drejtave dhe kompetencave të njohura nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit. Gjykata vlerëson se kërkuari nuk ka paraqitur argumente të tilla, por ai ka parashtruar vetëm pretendimin se nga ky konflikt janë cenuar kompetencat e Bashkisë Tiranë. Një pretendim të tillë mund ta parashtronte vetëm organi konkret i qeverisjes vendore, konkretisht Bashkia Tiranë, si

subjekt në mosmarrëveshje apo si e cenuar drejtpërdrejt nga mosmarrëveshja, gjë të cilën Bashkia Tiranë e ka realizuar duke iu drejtuar kësaj Gjykate me kërkesë, me të njëjtin objekt, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës midis Bashkisë Tiranë dhe Kuvendit të Shqipërisë si dhe shfuqizimin e vendimit nr. 66, datë 21.10.2010, të Kuvendit të Shqipërisë “Për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar” si të pajtueshëm me Kushtetutën (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.48/2011*). Nëse kërkuesi pretendon se ka një konflikt, i cili nuk është pengues në ushtrimin e funksioneve të tij, por mund të jetë në kundërshtim me normat kushtetuese, në këtë rast ai nuk mund t’i drejtohet Gjykatës në rrugën e kërkimit të konstatimit të konfliktit të kompetencave midis dy organeve. Mbrojtja e kushtetutshmërisë, si qëllimi final i kontrollit kushtetues, është një e drejtë/detyrë e subjekteve të përcaktuara qartë në dispozitat kushtetuese, në të cilat përcaktohen edhe rastet konkrete kur ata mund të venë në lëvizje Gjykatën për mbrojtje të kushtetutshmërisë gjatë veprimtarisë së tyre (*vendim i Mbledhjes së Gjyqtarëve nr.34/2011*).

Gjykata nuk e gjen të bazuar qëndrimin e kërkuesit se 1/5 e deputetëve nuk ka detyrim për të justifikuar interesin, sepse ka legjitimitet të pakushtëzuar. Gjykata vlerëson se 1/5 e deputetëve bën pjesë te subjektet e posaçme të parashikuara nga neni 134/1, shkronja “c” të Kushtetutës, por ky subjekt duhet të ketë një qëllim dhe nxitje konkrete për të kërkuar interpretimin e dispozitave të veçanta të Kushtetutës ose kontroll konkret të normës juridike, pasi e kundërta do t’i jepte kësaj Gjykate funksion këshillimor. Kur një grup deputetësh vë në lëvizje Gjykatën për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave, duhet që ai të pretendojë se atij i është cenuar një kompetencë e caktuar, gjithashtu, ai duhet të parashtojë se midis cilave organe ekziston konflikti, cila është kompetenca që ushtrohet nga organi tjetër dhe në ç’mënyrë pengohet ushtrimi i saj ose në ç’mënyrë një organ e ushtron pa të drejtë një kompetencë. Nëse këto elemente nuk arrijnë të identifikohen nga Gjykata në kërkesën e parashtruar asaj, ajo nuk mund të arrijë në një analizë dhe përfundim të qartë se cilit organ i takon të ushtrojë cilën kompetencë, si qëllimi final i shqyrtimit dhe kontrollit që bën Gjykata, referuar nenit 56/1 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Nuk është e mjaftueshme për Gjykatën fakti që të dyja palët kundërshtare në procesin e konfliktit të kompetencave të pretendojnë interpretim ose zbatim të gabuar të ligjit ose Kushtetutës, por midis palëve duhet të ekzistojë një marrëdhënie juridike në kuptimin kushtetues dhe nga kjo marrëdhënie të kenë ardhur pasoja të tilla që të kenë shkaktuar mosmarrëveshjen midis tyre. Gjithashtu, thjesht fakti se dy bartës të kompetencave kushtetuese kanë mendime të ndryshme mbi kushtetutshmërinë e një akti normativ, nuk është shkak i mjaftueshëm për të konkluduar në ekzistencën e një konflikti të kompetencave. Përndryshe, nga çdo rast i kontrollit abstrakt ose konkret do të lindte një konflikt kompetence, çka nuk është e pajtueshme me funksionin e kontrollit kushtetues për këtë qëllim (*vendimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nr.34/2011*). Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet në paraqitjen e kërkesës para kësaj Gjykate.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131, 134 të Kushtetutës dhe neneve 54, 56 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.



Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Admir Thanza

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Petrit Pllaçi

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka rrëzuar kërkesën e një grupi deputetesh për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit nr. 10449, datë 14.7.2011 “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë” me arsyetimin se nuk legjitimohen t’i drejtohen kësaj Gjykate për çështje që në thelb ngrenë probleme të konfliktit të kompetencave midis organeve të pushtetit qendror dhe atyre vendor dhe se vetëm këto organe, në rastin konkret Bashkia e Tiranës, mund të venë në lëvizje një gjykim kushtetues.

2. Jam i mendimit se kërkesa nuk ka për objekt konfliktin e kompetencave midis organeve të pushtetit qendror dhe atyre vendor por i referohet dispozitave konkrete të ligjit të sipërpërmendur që sipas kërkesit bien ndesh me Kushtetutën. Pavarësisht nga përmbajtja e dispozitave në fjalë, Gjykata është e detyruar t’i japë përgjigje me vendim pretendimeve lidhur me papajtueshmërinë ose jo të tyre me Kushtetutën. Argumentet e shumicës për ta rrëzuar kërkesën me arsyet e mësipërme më duken të sforcuara.

3. Duke qenë se mungesën e legjitimitimit të kërkesit në çështjen në fjalë e shoh nga një këndvështrim tjetër, më poshtë po jap arsyet e këtij mendimi paralel.

4. Nga pikëpamja formal juridike, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë (33 deputetë) i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për shpalljen si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 3, 5, 6, 8 të ligjit nr. 10449, datë 14.7.2011 “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë”.

5. Siç rezulton nga materialet e administruara në seancë plenare, më datë 14.7.2011, kur ligji është diskutuar dhe miratuar në Kuvend, grupi parlamentar në të cilin bëjnë pjesë edhe deputetët që kanë nënshkruar kërkesën drejtuar kësaj Gjykate, kanë bojkotuar punimet e Kuvendit.

6. Nisur nga praktika, tashmë të përsëritura, të bojkotit të punimeve të institucionit më të lartë ligjvënës në vend, Gjykata duhet të vinte në diskutim dhe t’u jepte përgjigje disa çështjeve me rëndësi parimore kushtetuese për funksionimin normal të institucioneve në një shtet të së drejtës:

6.1. A është bojkoti i institucioneve kushtetuese, në rastin konkret Kuvendit, një praktikë e justifikuar nga pikëpamja kushtetuese në një shtet të së drejtës?

6.2. Cili është kuptimi dhe dallimi midis mandatit detyrues (*shih nenin 70/1 të Kushtetutës*) dhe mandatit përfaqësues?

6.3. Çfarë ka pasur parasysh kushtetutëbërësi kur, në nenin 134 të Kushtetutës, krahas Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i ka njohur të drejtën edhe “jo më pak se një të pestës së deputetëve” për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në mënyrë të pakushtëzuar?

7. Problemi që shtrohej për zgjidhje para Gjykatës ishte: a legjitimohet një e pesta e deputetëve të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të kundërshtuar si antikushtetues një ligj për të cilin ajo i është shmangur me dashje detyrimit për të ushtruar të drejtat që burojnë nga statusi i të qenit deputet, për të marrë pjesë, debatuar dhe votuar ligjin në seancat e Kuvendit?

8. Në preambulën e Kushtetutës shpallet haptazi synimi kryesor i popullit shqiptar me rastin e hartimit dhe miratimit të saj, “*vendosmëria për të ndërtuar një shtet të së drejtës*”. Gjithë kapitujt e tjerë të Kushtetutës nuk janë gjë tjetër veçse një shpallje dhe zbatim i komponentëve themelorë të shtetit të së drejtës..

9. Kushtetuta pasi sanksionon në nenin 3 qëllimet dhe detyrat kryesore të shtetit shqiptar, duke vënë të drejtën si bazën dhe kufijtë e veprimtarisë të shtetit (neni 4), më tej në nenin 7

sanksionon parimin themelor të shtetit të së drejtës mbi të cilin mbështetet sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë, ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.

10. Funksionimi normal i institucioneve kushtetuese mbi bazën e këtyre parimeve është kusht i domosdoshëm për zhvillimin dhe përparimin për një shoqëri të lirë dhe demokratike. Në këtë kuptim roli i Kuvendit në një republikë parlamentare është i pazëvendësueshëm.

11. Në nenin 70, pika 1 të Kushtetutës thuhet se: “Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues”. Gjykata, duke bërë dallimin midis mandatit detyrues dhe atij përfaqësues, ka theksuar se parlamentarët, nëpërmjet mandatit të marrë nga zgjedhësit, ushtrojnë sovranitetin kombëtar. Mandati parlamentar, në parim, është i përgjithshëm, domethënë parlamentarët përfaqësojnë kombin si të tërë dhe jo një grup votuesish, gjithashtu ai është dhe përfaqësues, që do të thotë se deputetët nuk janë të lidhur pas ndonjë urdhri apo dëshire që vjen nga elektorati. Parlamentarët gëzojnë pavarësi të plotë përballë elektoratit por edhe ndaj grupimit politik ku ata bëjnë pjesë (*shih vendimin nr.44, datë 7.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ka theksuar se koncepti i mandatit parlamentar përmban detyrimin e përfaqësimit real të zgjedhësve. Populli merr pjesë në vendimmarrjen parlamentare nëpërmjet tërësisë të anëtarëve të tij dhe për këtë qëllim duhet të garantohet pjesëmarrja e të gjithë deputetëve në vendimmarrje. Nga parimi i demokracisë përfaqësuese rrjedh detyrimi i deputetit që mandatin e besuar nga zgjedhësit ta ushtrojë realisht. Vetëm duke qenë plotësisht efektiv, pra i përfaqësuar tërësisht me të gjithë anëtarët e tij, parlamenti mund të realizojë funksionin e tij demokratik (*shih vendimin BverfGE 1/06, datë 4.7.2007, të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane*).

13. Sipas Gjykatës, nëse deputetët për arsye të ndryshme, ndalohen ose pengohen të ushtrojnë funksionin e tyre si pjesë e parlamentit, cenohet parimi i përfaqësimit si dhe raporti shumicë/pakicë i vendosur nga vullneti i zgjedhësve dhe që duhet të gjejë patjetër pasqyrim aty ku formohet vullneti politik i zgjedhësve, në parlament. Nisur nga tërësia e karakteristikave që mbart në vetvete mandati parlamentar, deputeti nuk i nënshtrohet urdhrave, ndryshe nga pjesa tjetër e punonjësve ose nëpunësve të shërbimit civil (*shih vendimin BverfGE 1/06, datë 4.7.2007, të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane*).

14. Thelbi i mandatit përfaqësues (ose siç quhet ndryshe në jurisprudencën kushtetuese edhe “mandat i lirë” për ta dalluar nga “mandati detyrues”) qëndron në faktin se anëtarët e parlamentit duhet të jenë të lirë të ushtrojnë të drejtat dhe detyrat e tyre në parlament pa u kufizuar nga mandatet e elektoratit, nga kërkesat politike të partive ose organizatave që i kanë promovuar. Kështu, nga njëra anë deputetët forcojnë pavarësinë e tyre në marrjen e vendimeve dhe nga ana tjetër përmbushin detyrimet që burojnë nga Kushtetuta dhe ligjet për të cilën ata edhe janë betuar në një akt solemn, aspak formal (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Lituaniës, datë 15.5.2009*).

15. Në këtë kuptim është e domosdoshme të bëhet dallimi midis bojkotit si pjesë e luftës politike me bojkotin e institucioneve kushtetuese, në rastin konkret Kuvendit. Ndërsa e para është një praktike normale në veprimtarinë me karakter politik të partive politike, përkundrazi, bojkoti i Kuvendit për çfarëdolloj arsye është një praktikë antikushtetuese, e papranueshme për një shtet të së drejtës. Nga momenti i certifikimit të zgjedhjeve politike dhe konstituimit të Kuvendit pjesëmarrja e deputetëve në veprimtarinë ligjvënëse të tij është e detyrueshme në kuptimin kushtetues për të formuar atë që quhet “mandati kolektiv i parlamentit”, si dhe vullnetin politik të zgjedhësve.

16. Duke arsyetuar më tej, nga detyrimi i mësipërm burojnë edhe disa të drejta që gëzojnë deputetët të cilat janë të natyrës ligjore (p.sh statusi i deputetëve) apo dhe kushtetuese (*shih nenin 73 të Kushtetutës*).

17. Mendoj se nga ky këndvështrim duhet vlerësuar edhe e drejta që i njeh Kushtetuta jo më pak se një të pestës së deputetëve për të vënë në lëvizje në mënyrë të pakushtëzuar Gjykatën Kushtetuese.

18. Mosnjohja e Kuvendit apo bojkoti i qëllimshëm i punimeve të tij i heqin mundësinë,



në kuptimin kushtetues, grupit të deputetëve për të shfrytëzuar një të drejtë kushtetuese të njohur jo vetëm për shkak të qenies si të tillë por në radhë të parë për shkak të përmbushjes të detyrimit për të marrë pjesë dhe për të ushtruar efektivisht mandatin përfaqësues brenda Kuvendit.

19. Sipas nenit 59 të Rregullores së Kuvendit deputeti ka tre opsione për të shprehur vullnetin e tij nëpërmjet votës; pro, kundër ose abstenim. Abstenimi, në terma juridikë, nuk është gjë tjetër veçse bojkot që i bëhet një ligji të paraqitur nga qeveria në Kuvend. Ky është një argument tjetër për të deligjitimuar bojkotet nëpërmjet mos njohjes apo mospjesëmarrjes në punimet e Kuvendit.

20. Nisur nga sa më sipër mendoj se në çështjen konkrete jo më pak se një e pesta e deputetëve nuk legjitimohen të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues. Duke bojkotuar punimet e Kuvendit, ditën që do të merrej në shqyrtim ligji objekt kundërshtimi, në zbatim të një mandati detyrues që buron nga qenia e grupit të deputetëve anëtarë të një partie politike, ata kanë vepruar në kundërshtim me detyrimet kushtetuese dhe në këtë kuptim nuk mund të përfitojnë nga e drejta që ju njihet neni 134/1/c i Kushtetutës. Nuk mund të ketë dy standarde në qëndrimin ndaj Kushtetutës.

21. Në rrethanat e mësipërme kërkuesit mund t'i drejtoheshin kësaj Gjykate në kuadrin e germës "f", të nenit 134/1 të Kushtetutës, që i njeh të drejtën partive politike për të iniciuar një gjykim kushtetues, me kusht që të argumentonin interesin e tyre për çështjen, detyrim ky që buron nga pika 2 e nenit 134 të Kushtetutës.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, në lidhje me argumentet e saj për rrëzimin e kërkesës, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice. Shumica, në këtë çështje, ka arritur në përfundimin se kërkuesi (një e pesta e deputetëve) nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për kërkimet e tij. Në arsyetimin e saj, shumica shprehet se një e pesta e deputetëve bën pjesë te subjektet e posaçme të parashikuara nga neni 134/1 shkronja "c" i Kushtetutës, ndaj ky subjekt duhet të ketë një qëllim dhe nxitje konkrete që të legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës. Më tej, në lidhje me objektin, shumica ka konkluduar se kërkuesi në vetvete kërkon "*zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor*" dhe ka vlerësuar se kërkuesi nuk është as subjekt në konflikt e as subjekt i cenuar drejtpërdrejt nga konflikti. Pakica mendon se ky qëndrim i shumicës nuk gjen mbështetje në parashikimet dhe frymën kushtetuese, apo dhe në vetë jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

Bazuar në nenin 134/1, shkronja "c" të Kushtetutës, një e pesta e deputetëve është një ndër subjektet të cilët mund ta vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Nisur nga formulimi i dispozitës në pikën 2 të po këtij neni dhe duke bërë një interpretim sistematik të saj, arrihet në përfundimin logjik se ky nen i ndan subjektet, që mund të iniciojnë një gjykim kushtetues, në dy kategori; në kategorinë e parë përfshihen subjektet për të cilët Kushtetuta nuk parashikon detyrimin për të provuar interesin në çështjen konkrete (Presidenti i Republikës; Kryeministri; jo më pak se një e pesta e deputetëve; Kryetarit i Kontrollit të Lartë të Shtetit; çdo gjykatë sipas rastit të nenit 145 pika 2 të Kushtetutës); ndërsa në kategorinë e dytë bëjnë pjesë subjektet të cilat duhet të provojnë interesin e tyre në çështjen konkrete (Avokati i Popullit; organet e qeverisjes vendore; organet e bashkësive fetare; partitë politike dhe organizata të tjera; individët). Është e qartë se ky parashikim kushtetues iu kushtëzon legjitimitimin për t'iu drejtuar Gjykatës subjekteve të kategorisë së dytë. Jo pa qëllim janë zgjedhur nga kushtetutbërësi si subjekte me legjitimitet të pakushtëzuar përfaqësues të tre organeve qendrore (Presidenti, Këshilli i Ministrave, Parlamenti) duke iu njohur atyre të drejtën e pakushtëzuar për t'iu drejtuar Gjykatës, në funksion të kontrollit kushtetues të ligjeve dhe akteve

normative. Kjo zgjedhje bën të mundur ushtrimin e kontrollit ndaj pushtetit që zotërojnë këto organe qendrore. Procedura e kontrollit kushtetues është një mekanizëm nëpërmjet të cilit këto organe qendrore kontrollojnë dhe balancojnë pushtetin e njëri-tjetrit, në shërbim të interesit parësor të mbrojtjes së rendit kushtetues dhe forcimit të shtetit të së drejtës.

Përfshirja e një të pestës së deputetëve në rrethin e subjekteve të cilët kanë të drejtë të kërkojnë kontrollin kushtetues të ligjeve në mënyrë të pakushtëzuar, ka një vlerë të veçantë në aspektin kushtetues. Nga interpretimi teleologjik i nenit 134/1, shkronja “c”, pakica vlerëson se synimi i kushtetutbërësit ka qenë mbrojtja e të drejtës së pakicës parlamentare për të kërkuar kontrollin kushtetues, *inter alia*, të ligjeve të miratuara nga shumica parlamentare, çka është shumë e rëndësishme për funksionimin e një shteti demokratik. Demokracia nënkupton që të drejtat e pakicës parlamentare duhet të mbrohen ashtu sikundër mbrohet dhe qeverisja e shumicës, për të garantuar mbi të gjitha interesat e qytetarëve. Pra, në thelb të legjitimitimit të pakushtëzuar të një të pestës së deputetëve, të parashikuar nga Kushtetuta, qëndrojnë interesat e qytetarëve, realizimi i të cilave është i lidhur ngushtë me vendim-marrjen e organeve qendrore shtetërore.

Parimi i sovranitetit të popullit është pjesë e vlerave themelore të mbrojtura nga vetë Kushtetuta. Sovraniteti i takon popullit që e ushtron atë në format dhe brenda kufijve të përcaktuara në Kushtetutë. Nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Parlament, qytetarëve iu është dhënë mundësia për të marrë pjesë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë në vendimet që marrin organet qendrore kushtetuese, të cilat i shtrijnë efektet tek interesat e tyre. Në një demokraci përfaqësuese, qytetarët përfshihen në një proces përzgjedhës të anëtarëve të Parlamentit, proces që mbështetet në ekzistencën e një marrëdhënieje mirëbesimi midis qytetarëve (elektoratit) dhe anëtarëve të Parlamentit. Megjithëse çdo deputet zgjidhet nga një zonë elektorale e caktuar, pasi zgjidhet dhe bëhet pjesë e Parlamentit, ai kryen funksionin e tij si deputet në interes të të gjithë qytetarëve. Në vijim të këtij arsytimi, deputetët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre përfaqësojnë të gjithë qytetarët dhe jo vetëm atë pjesë të tyre që i ka zgjedhur; ndaj kësaj pjese të elektoratit ata përgjigjen vetëm politikisht. Prandaj, pritshmëria e qytetarëve është që opozita të kundërshtojë në Gjykatën Kushtetuese një ligj i cili është problematik në aspektin kushtetues. *Ad contrario*, nëse opozita dështon në iniciimin e kontrollit kushtetues të ligjit, kjo mund të konsiderohet si një neglizhencë dhe paaftësi nga ana e saj.

Roli i Gjykatës është mjaft i rëndësishëm pasi është ajo që duhet të garantojë një kontroll dhe vlerësim të paanshëm të ligjit në kuadrin kushtetues. Prandaj, një e pesta e deputetëve, si iniciues të procesit të kontrollit kushtetues të ligjeve dhe Gjykata, si vlerësuese e kushtetutshmërisë së tyre, janë pjesë e pandarë e sistemit të kontroleve dhe balancave (*checks and balances*), që është thelbësor për ekzistencën e një shteti demokratik. Demokracia nuk mund të kuptohet vetëm si një proces i projektuar në drejtim të garantimit të vendim-marrjes së shumicës parlamentare; opozita duhet të ketë mekanizma të përshtatshme që të kontrollojë pushtetin e shumicës. Në këtë këndvështrim, neni 134 i Kushtetutës përbën një garanci për opozitën duke i mundësuar vënien në lëvizje të Gjykatës për të kërkuar kontrollin konkret të një ligji. Është e nënkuptuar se opozita, në raport me subjektet e tjera që gëzojnë legjitimitim të pakushtëzuar, duke qenë pjesë e organit legjislativ dhe për shkak të pozicionit të saj në sistemin politik, ka një interes më të madh për të sjellë përpara Gjykatës ligjet e miratuara nga shumica parlamentare, për t’ia nënshtruar ato kontrollit kushtetues. Në një demokraci parlamentare, parimi i prevalencës së shumicës në vendimmarrje, është ngushtësisht i lidhur me garancitë që duhet t’i ofrohen pakicës për të kundërshtuar këtë vendim-marrje, në aspektin kushtetues. Në këtë kontekst pakica evidenton se është hera e parë që shumica, me qëndrimin e saj, nuk ka legjitimuar pakicën parlamentare t’i drejtohet Gjykatës për të kërkuar kontrollin kushtetues të një ligji.

Në lidhje me çështjen e legjitimitimit të një të pestës së deputetëve, në vendimin e saj nr. 18, datë 29.7.2008, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “*Për sa i përket legjitimitimit (locus standi) të kërkuarit, Gjykata vlerëson se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka ndjekur një praktikë të*



njohur dhe të gjithë pranuar, ku e drejta për të iniciuar një procedurë të kontrollit abstrakt të normës i njihet edhe një numri të kufizuar të deputetëve, që nuk mund të jetë më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit. Interesi i këtyre bartësve të funksionit publik për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtet-formuese si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj. të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar”. Gjykata ka pohuar gjithashtu se “Kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë së normës mund të zbatohet ndaj akteve të mësipërme, pavarësisht nga efekti që ato mund kenë në një konflikt aktual apo të pritshëm. “Për Gjykatën Kushtetuese është i njohur rregulli i pranuar në doktrinë dhe në jurisprudencën kushtetuese, se gjatë kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së një norme juridike nuk kërkohet ardhja e pasojës për të legjitimuar kërkesin. Tipari dallues i një kërkesë të tillë është se ajo vë në lëvizje një kontroll abstrakt e objektiv të ligjit, pasi interesi që kërkohet të mbrohet nuk është thjesht individual, por është një interes që lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës. Qëllimi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve është njëkohësisht edhe parandalimi i pasojave negative që mund të vijnë nga zbatimi i tyre.” (shih vendimin nr. 1, datë 7.1.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

Në këtë drejtim ka ecur dhe Gjykata Kushtetuese Gjermane (GJKGJ), e cila, nëpërmjet jurisprudencës së saj, ka mbrojtur vendosmërisht të drejtat e opozitës, në pozicionin e pakicës parlamentare¹. Kjo Gjykatë, ndër të tjera, është shprehur se një opozitë parlamentare efektive përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit të ndarjes së pushteteve në një sistem politik ku i njëjti koalicion kontrollon si Parlamentin ashtu edhe Ekzekutivin. Në çështjen për komisionet hetimore parlamentare, iniciuar nga një e katërta e deputetëve, GJKGJ është shprehur se “kuptimi kushtetues i të drejtës së pakicës qëndron në garantimin e kontrollit që ushtron Parlamenti mbi Ekzekutivin dhe administratën (...) në një sistem parlamentar nuk është detyra e shumicës parlamentare të monitorojë qeverinë/qeverisjen e vendit por e opozitës dhe si rregull e pakicës parlamentare. Nëse kontrolli parlamentar synon të arrijë qëllimin e tij, e drejta kushtetuese e pakicës parlamentare për të ngritur një komision hetimor nuk duhet të dëmtohet (...) nëse kjo e drejtë dobësohet në mënyrë të padrejtë, pakica privohet nga përdorimi i një mekanizmi garantues, i cili i është besuar jo për interesat e saj por për interesat e shtetit demokratik” (shih Schleswig-Holstein Investigative Committee case (1978) 49 BVerfGE 70; përkthim i Gjykatës).

Po kështu, në raportin e Komisionit të Venecias (2008) dhe në Rezolutën nr. 1601/2008 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës mbi rolin e opozitës në një parlament demokratik, rekomandohet se një pakicë parlamentare duhet të ketë të drejtë të kërkojë shqyrtimin kushtetues të ligjeve, qoftë para ose pas miratimit, nga gjykata kushtetuese. Kjo është një kompetencë që i jep opozitës (një fraksioni të caktuar të saj) mundësinë për të sjellë ligjet dhe aktet tjera të shumicës parlamentare përpara një autoriteti të pavarur gjyqësor² (përkthim i Gjykatës).

Duke pasur parasysh çka më sipër dhe referuar përmbajtjes së pikës 2 të nenit 134 të Kushtetutës, pakica vlerëson se, nuk është e domosdoshme që çështja konkrete e sjellë prej kërkesit përpara Gjykatës të lidhet drejtpërdrejtë me interesat e tij. Kërkesi gëzon legjitimitet të pakushtëzuar, të cilin e ka ushtruar në përputhje me dispozitat kushtetuese përkatëse. Një e pesta e deputetëve ka investuar Gjykatën në funksion të kontrollit kushtetues ndaj disa dispozitave ligjore, të cilat sipas vlerësimit të tyre, janë të papajtueshme me Kushtetutën.

Për sa i përket objektit të këtij gjykimi kushtetues, pakica vëren se, ndryshe nga sa ka vlerësuar shumica, kërkesi nuk ka investuar Gjykatën për zgjidhje të mosmarrëveshjes së

¹ Shih “The constitutional jurisprudence of the Federal Republic of Germany”, Donald. P. Kommers, 1997 fq. 169-170

² Study no. 497/2008 Strasbourg, 6 October 2010 “Comments on the role of the opposition in a democratic parliament” 4.5 §134; §136; Resolution no. 1601/2008 of Parliamentary Assembly of the Council of Europe, par. (2.7); (2.7.1); (2.7.2)

kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor, por për kontrollin kushtetues të një akti normativ konkret të një organi qendror, konkretisht të ligjit nr. 10449, datë 14.7.2011 “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë” të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Si neni 131 i Kushtetutës në shkronjat “a” dhe “ç”, ashtu edhe nenet 49-51 dhe 54-56 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” përcaktojnë një dallim të qartë ndërmjet çështjes të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën dhe çështjes së mosmarrëveshjes së kompetencës midis pushteteve. Çështja e pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën qëndron në mënyrë të pavarur nga çështja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushteteve. Megjithatë, pavarësisht se këto çështje identifikohen si objekte të ndryshme në gjykimin kushtetues, ato mund të gërshetohen sidomos në rastet kur mosmarrëveshja e kompetencës shkaktohet nga ligji në përgjithësi apo dispozita specifike të tij në veçanti. Nëse i referohemi jurisprudencës kushtetuese, ndeshim raste kur Gjykata ka marrë në shqyrtim pajtueshmërinë e një ligji me Kushtetutën, edhe kur një kërkim i tillë asaj i është parashtruar në kuadrin e çështjes për zgjidhje të konfliktit të kompetencave apo edhe raste kur çështja e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën asaj i është parashtruar nga jo me pak se një e pesta e deputetëve me pretendimin se dispozita të veçanta ligjore cenonin parimin e ndarjes së pushteteve, të decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore (*shih vendimet nr. 29, datë 21.12.2006 dhe nr. 3, datë 2.2.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në çështjen konkrete, shumica e ka vlerësuar objektin e kërkesës në mënyrë të ndryshme nga thelbi i pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi. Objekti i pretendimeve të kërkuarit janë disa dispozita specifike të ligjit që kundërshtohet, të cilat, sipas tij, bien ndesh me parimet kushtetuese të ndarjes dhe balancimit të pushteteve; të shtetit të së drejtës; të ruajtjes së trashëgimisë kulturore; të transparencës financiare që duhet të karakterizojë miratimin e ligjeve. Këto pretendime nuk janë marrë parasysh nga shumica në vlerësimin e objektit, dhe për shkak të konkluzionit të saj në drejtim të moslegjitimitit të kërkuarit, nuk kanë marrë përgjigje. Duke e vlerësuar objektin e kërkesës në planin e konfliktit të kompetencave, shumica ka arsyetuar se kërkuesi nuk është as subjekt në konflikt e as subjekt i cenuar drejtpërdrejt nga konflikti; në rastin konkret, grupi i deputetëve është përqendruar në mbrojtjen e sferës së veprimtarisë së pushtetit vendor dhe jo të të drejtave të veta si pakicë parlamentare. Duke shkuar më tej, shumica ka theksuar se një pretendim të tillë për konflikt kompetencash mund ta parashtrtojë vetëm organi konkret i qeverisjes vendore, gjë të cilën Bashkia Tiranë e ka realizuar duke iu drejtuar kësaj Gjykate me kërkesë, me të njëjtin objekt, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës midis Bashkisë Tiranë dhe Kuvendit të Shqipërisë si dhe shfuqizimin e vendimit nr. 66, datë 21.10.2010, të Kuvendit të Shqipërisë “Për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar” si të papajtueshëm me Kushtetutën (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.48/2011*). Pakica e çmon të rëndësishme të theksojë se në vendimin nr. 48/2011, të cituar nga shumica, objekt i kontrollit kushtetues ka qenë një vendim individual i Kuvendit dhe jo një ligj, si në rastin konkret.

Si përfundim, bazuar në argumentet e mësipërme, pakica vlerëson se, qëndrimi i shumicës, në çështjen objekt shqyrtimi, shkon në drejtim të ngushtimit të së drejtës së një të pestës së deputetëve për të kërkuar kontrollin abstrakt të ligjeve dhe akteve normative, çka bie në kundërshtim me frymën dhe parashikimet kushtetuese, si dhe me vetë jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

Anëtarë: Sokol Berberi, Petrit Pllloçi

MENDIM PAKICE

Unë, gjyqtarja në pakicë, nuk jam dakord me qëndrimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës për shkak të moslegjitimitit të kërkuarit, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.



Shumica, në vendimin e saj, vëren se, duke iu referuar natyrës dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara gjatë gjykimit, kërkuesi ka kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet një organi të pushtetit qendror dhe një organi të qeverisjes vendore. Më tej, ajo ka vlerësuar se, që të iniciohet një çështje për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje kompetencash midis pushteteve, kërkesa duhet të ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti. Në rastin në shqyrtim, duke pasur parasysh pretendimet e kërkuesit, shumica ka vlerësuar se kërkuesi nuk është as subjekt në konflikt dhe as subjekt i cenuar drejtpërdrejt nga konflikti dhe, në këto kushte, nuk legjitimohet për ngritjen e kësaj kërkesë.

Gjykata Kushtetuese e realizon procedurën abstrakte të kontrollit të pajtueshmërisë së ligjit dhe akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën në zbatim të nenit 131, shkronja “a” dhe “c” të Kushtetutës.

Bazuar në nenin 134, pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës, e drejta për të iniciuar një procedurë të kontrollit abstrakt të normës i njihet edhe një numri të kufizuar të deputetëve, që nuk mund të jetë më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit. Ndërkohë që për disa nga subjektet e parashikuara në pikën 1 të nenit 134 të Kushtetutës kërkohet që të provojnë interesin e tyre në çështjen kushtetuese të ngritur, lidhur me subjektin e parashikuar në shkronjën “c” të nenit 134/1, jo më pak se një e pesta e deputetëve, dispozita kushtetuese i njeh të drejtën që për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës, të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret (*shih vendimet nr.3, datë 2.2.2009; nr.9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Interesi i këtyre bartësve të funksionit publik për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj. të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar. Kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë së normës mund të zbatohet ndaj akteve të mësipërme, pavarësisht nga efekti që ato mund kenë në një konflikt aktual apo të pritshëm. Për Gjykatën Kushtetuese është i njohur rregulli i pranuar në doktrinë dhe në jurisprudencën kushtetuese, se gjatë kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së një norme juridike nuk kërkohet ardhja e pasojës për të legjitimuar kërkuesin. Tipari dallues i një kërkesë të tillë është se ajo vë në lëvizje një kontroll abstrakt e objektiv të ligjit, pasi interesi që kërkohet të mbrohet nuk është thjesht individual, por është një interes që lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës. Qëllimi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve është njëkohësisht edhe parandalimi i pasojave negative që mund të vijnë nga zbatimi i tyre (*shih vendimet nr.1, datë 7.1.2005; nr.18, datë 29.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në lidhje me kompetencën e saj të parashikuar në nenin 131, shkronja “ç” të Kushtetutës, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës ndërmjet pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor) si dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror - qeverisje vendore), Gjykata Kushtetuese ka theksuar se mosmarrëveshja e kompetencës mund të paraqitet në formën e konfliktit “normativ”, kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu si edhe në formën e konfliktit “individual”, kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse për zbatimin e një ligji konkret, akt i cili bëhet shkak për mosmarrëveshje. Mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen edhe kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, kur e njëjta kompetencë u atribuohet sipas ligjeve të ndryshme dy institucioneve, si dhe kur ligji parashikon kompetencën, por pa saktësuar organin që duhet ta ushtrojë (*shih vendimet nr.29, datë 21.12.2006; nr.26, datë 4.12.2006; nr.22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për zgjidhjen e një konflikti kompetencash, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti dhe ajo vendos se cili organ i pushtetit ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes konkrete për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Veç kësaj, kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ka të bëjë me akte

ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata Kushtetuese shqyrton gjithashtu edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit.

Në rastin në shqyrtim, unë gjyqtarja në pakicë vërej se kërkuesi nuk i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për zgjidhjen e një konflikti kompetencash mes një organi të qeverisjes qendrore dhe një organi të qeverisjes vendore, konflikt që si i tillë do të kërkonte për kërkuenin të provonte cilësinë e tij si palë në konflikt. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin, si jokushtetues, të ligjit nr.10 449, datë 14.7.2011 “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë”, duke pretenduar se ky ligj bie ndesh me disa parime kushtetuese, si ai i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, i sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, parimi i hierarkisë së akteve normative dhe i sigurisë juridike si elemente të parimit të shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës. Pra, në thelb, kërkuesi i ka kërkuar kësaj Gjykate të ushtrojë një kontroll abstrakt të normës dhe të shprehet lidhur me pajtueshmërisë e ligjit të kundërshtuar me Kushtetutën. Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese nuk mund të vinte në diskutim legjitimitimin e një subjekti të pakushtëzuar dhe as të orientonte një konflikt të paraqitur si konflikt i një ligji me Kushtetutën drejt në një konflikti kompetencash mes pushteteve.

Për sa më sipër, vlerësoj se Gjykata Kushtetuese nuk duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës për shkak të moslegjitimitimit të kërkuetit, por duhej të shqyrtonte çështjen në thelb dhe t’i jepte përgjigje pretendimeve të parashtruara prej kërkuetit.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

Nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, pasi mendoj se një e pesta e deputetëve legjitimohet për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për shfuqizimin e neneve 3, 5, 6, 8 të ligjit nr. 10449, datë 14.7.2011 “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë”, për arsyet e mëposhtme:

1. Shumica, duke iu referuar natyrës dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi gjatë gjykimit, ka vlerësuar se ato kanë të bëjnë me zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet një organi të pushtetit qendror, Kuvendit të Shqipërisë dhe një organi të qeverisjes vendore, Bashkisë Tiranë. Mbi këtë bazë, shumica nuk e ka legjitimuar kërkuenin, duke argumentuar, në thelb, se një e pesta e deputetëve bën pjesë te subjektet e posaçme të parashikuara nga neni 134/1 shkronja “c” i Kushtetutës dhe që duhet të ketë një qëllim dhe nxitje konkrete që të legjitimohet për interpretimin e dispozitave të veçanta të Kushtetutës ose kontroll konkret të normës juridike. Në të kundërt, kësaj Gjykate do i jepej funksion këshillimor.

2. Ndaj mendim të ndryshëm me shumicën për sa i përket natyrës dhe objektit të çështjes të marrë në shqyrtim, për të cilin Gjykata ka konkluduar se kërkuesi në vetvete kërkon “*zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor*”. Në arsyetimin e saj, shumica i përmbledh pretendimet dhe i emërton “konflikt kompetencash”, ndërkohë që ato janë një natyrë krejtësisht të ndryshme. Nisur nga ky fakt, mendoj se argumenti i shumicës është i pabazuar, pasi objekti i çështjes përcaktohet në varësi të kërimit dhe mënyrës se si janë formuluar parashtrimet e kërkuetit, të cilat në rastin konkret kanë të bëjnë me pretendime për cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve, parimit të shtetit të së drejtës si rezultat i mosrespektimit të hierarkisë së akteve normative apo sigurisë juridike, etj... . Është e vërtetë se një mosmarrëveshje kompetencash lind si rezultat i mosrespektimit të parimit të ndarjes së pushteteve nga organet qoftë në rrafsh horizontal apo vertikal apo dhe nga subjekte të tjera jashtë këtyre niveleve, por në asnjë rast nuk duhet vlerësuar si e vetmja pasojë e kësaj shkeljeje. Në këtë kuptim, mendoj se një riformulimi dhe trajtimi i ndryshëm i pretendimeve nga ana e shumicës është i gabuar, për faktin se e drejta e disponimit për objektin i takon tërësisht kërkuetit, çka do të thotë se Gjykatës i mbetet të vlerësojë



nëse subjekti që e ka vënë në lëvizje legjitimohet ose jo për kërkuar shfuqizimin e ligjit, në referim të nenit 131, germa “a” të Kushtetutës.

3. Jurisprudenca e kësaj Gjykate ka pranuar se jo më pak se një e pesta e deputetëve, në referim të nenit 134, pika 1 të Kushtetutës dhe normave të ligjit nr.8577, datë 2.10.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, është subjekt i posaçëm, ose i pakushtëzuar, për vetë faktin se ata mund të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues përmes paraqitjes së një kërkesë, pa qenë e nevojshme të provojnë pasjen e ndonjë interesi në çështjen në fjalë. Konkretisht, Gjykata është shprehur se: “Për sa i përket legjitimitit (*locus standi*) të kërkuarit, Gjykata vlerëson se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka ndjekur një praktikë të njohur dhe të gjithë pranuar, ku e drejta për të iniciuar një procedurë të kontrollit abstrakt të normës i njihet edhe një numri të kufizuar të deputetëve, që nuk mund të jetë më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit. Interesi i këtyre bartësve të funksionit publik për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtet-formuese si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj. të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar” (shih vendimin nr. 18 datë 29.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese). Po ashtu, Gjykata ka pohuar se: “Për Gjykatën Kushtetuese është i njohur rregulli i pranuar në doktrinë dhe në jurisprudencën kushtetuese, se gjatë kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së një norme juridike nuk kërkohet ardhja e pasojës për të legjitimuar kërkuarin. Tipari dallues i një kërkesë të tillë është se ajo vë në lëvizje një kontroll abstrakt e objektiv të ligjit, pasi interesi që kërkohet të mbrohet nuk është thjesht individual, por është një interes që lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës. Qëllimi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve është njëkohësisht edhe parandalimi i pasojave negative që mund të vijnë nga zbatimi i tyre.” (shih vendimin nr. 1, datë 7.1.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

4. Në vështrim të sa më sipër, mendoj se moslegjitimimi i kërkuarit për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues, bie ndesh me standardet e përpunuara nga jurisprudenca e konsoliduar kushtetuese. Arsyetimi i shumicës për të pasur “qëllim dhe nxitje konkrete” përbën një kriter të ri, tej atyre të përcaktuara shprehimisht nga Kushtetuta që duhet të plotësohen nga jo më pak se një e pesta e deputetëve për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues në çështje me objekt shfuqizimin e ligjit. Përpunimi i këtyre kriterëve të reja, ka çuar, si rrjedhojë, në moslegjitimimin për herë të parë të jo më pak se një të pestës së deputetëve të cilët kërkojnë shfuqizimin e ligjit në referim të nenit 131, pika 1, germa “a”, duke ndryshuar, kështu, në mënyrë të paargumentuar qëndrimin e konsoliduar të jurisprudencës kushtetuese lidhur me legjitimimin e pakushtëzuar të kësaj kategorie subjektsh si dhe garancitë kushtetuese që gëzojnë pakicat parlamentare.

Anëtare: Vitore Tusha

VENDIM
Nr.26, datë 8.5.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Ploçi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare e “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “

me sekretare Enina Mullaj, në datë 7.6.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 22/5 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ismet Boriçi, përfaqësuar nga avokat Përparim Sanxhaku, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimeve: nr.19, datë 7.5.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 50, datë 1.11.2007 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 394, datë 8.7.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31/ç, 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), rezoluta nr. 11, datë 21.5.1975 e Komitetit të Këshillit të Ministrave.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha; përfaqësuesin e kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr.19, datë 7.5.2007 ka deklaruar kërkuarin fajtor për veprën penale “të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar nga neni 79/e dhe 25 i Kodit Penal (KP) dhe e ka dënuar me 25 vjet burg.

2. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, mbi ankimin e kërkuarit dhe të Prokurorisë për Krime të Rënda, me vendimin nr.50, datë 1.11.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për kërkuarin dhe ndryshimin e këtij vendimi për të pandehurit e tjerë.

3. Gjykata e Lartë, mbi rekursin e kërkuarit, me vendimin nr. 394, datë 8.7.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda për kërkuarin (dhe një të pandehur tjetër), prishjen e këtij vendimi për dy të pandehurit e tjerë dhe lënien në fuqi për këta të fundit të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

4. Kërkuari Ismet Boriçi, në datën 29.12.2010 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve të mësipërme duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur argumentet si më poshtë:

4.1 Është cenuar e drejta e gjyqësorisë të çështjes nga gjykata e caktuar me ligj, pasi çështja është gjykuar nga gjykata që nuk kishin kompetencë lëndore.

4.2 Është cenuar e drejta për t’u mbrojtur, pasi në gjykimin e zhvilluar në mungesë, ai është përfaqësuar nga mbrojtësi i zgjedhur prej të afërmeve pa pëlqimin e tij.

II

A. Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së gjyqësorisë nga një gjykatë e caktuar me ligj

5. Kërkuari pretendon se është gjykuar nga Gjykata për Krime të Rënda për veprën penale “të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar nga neni 79 shkronja “e” i KP-së kur duhej të gjykohej nga gjykatat e zakonshme të rretheve gjyqësore dhe si rrjedhojë është cenuar e drejta kushtetuese për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës e të nenit 6 të KEDNJ-së.

6. Gjykata Kushtetuese rithekson se, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së



Republikës së Shqipërisë, kërkuesi mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që kanë lidhje me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme. Shterimi i mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, kërkon që individi të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për rivendosjen e të drejtave të pretenduara (*shih vendimet nr.1, datë 25.1.2010; nr.36 datë 10.11.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga kërkuesi, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr.6, datë 4.3.2010; nr.32, datë 28.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Nga rrethanat e çështjes konkrete rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 28.1.2004 ka regjistruar procedimin penal nr.131 në ngarkim të shtetasve Ismet Borici e të tjerë për veprën penale "të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese" në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 79, shkronja "e" dhe 25 të KP-së.

9. Me vendimin e datës 16.3.2004, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, në mbështetje të neneve 75/a, 28 dhe 84 të KPP-së, të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës për Krime të Rënda" dhe të urdhrin nr.227, datë 19.12.2003 të Prokurorit të Përgjithshëm, ka shpallur moskompetencën lëndore për vazhdimin e hetimeve për këtë procedim penal dhe kalimin e akteve Prokurorisë për Krime të Rënda. Kjo e fundit, në datën 25.3.2004 ka regjistruar procedimin nr.100 dhe në datën 20.10.2004 ia ka kaluar dosjen për gjykim, sipas kompetencës lëndore, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila ka zhvilluar seancën e parë gjyqësore në datën 16.11.2004.

10. Ndërkohë, në datën 22.10.2004 ka hyrë në fuqi ligji nr.9276, datë 16.9.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë", neni 4 i të cilit parashikonte, midis të tjerash, se kompetenca lëndore e gjykimit të veprës penale, parashikuar nga neni 79/e, nuk i përkiste më gjykatave të krimeve të rënda, por gjykatave të zakonshme të rretheve gjyqësore.

11. Gjatë gjykimit të çështjes, konkretisht në seancën e datës 3.2.2005, rezulton se mbrojtësit e të pandehurve të tjerë kanë pretenduar moskompetencën lëndore të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Kjo kërkesë është kundërshtuar nga Prokurori i çështjes dhe është rrëzuar nga Gjykata me arsyetimin se ligji nr.9276, datë 16.9.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë" nuk ka dispozita kalimtare për kompetencën e gjykimit të çështjeve të regjistruara pranë gjykatave. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vlerësuar kompetencën e saj duke arsyetuar se çështja është regjistruar në datë 21.10.2004 dhe ligji ka hyrë në fuqi në datën 22.10.2004, pasi çështja është regjistruar.

12. Gjykata konstaton se kërkuesi apo mbrojtësi i tij nuk ka parashtruar pretendimin për moskompetencën lëndorë të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda gjatë gjykimit të zhvilluar në këtë gjykatë dhe as në ankimin përpara Gjykatës së Apelit apo në recurs. Pretendimi për moskompetencën e Gjykatës e Shkallës së Parë për Krime të Rënda është ngritur vetëm nga mbrojtësit e të pandehurve të tjerë gjatë seancës së datës 3.2.2005 zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

13. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe të rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në kuptim të nenit 131/f të

Kushtetutës, për rrjedhojë, nuk mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së gjyimit të çështjes nga gjykata e caktuar me ligj.

B. Në lidhje me pretendimin për cenimin e të drejtës së mbrojtjes

14. Kërkuesi pretendon se, gjatë gjyimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda dhe në Gjykatën e Lartë, i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, si rrjedhojë e zhvillimit të gjyimit në mungesë të tij. Sipas kërkuesit, këto standarde kushtetuese janë cenuar pasi gjykatat nuk kanë respektuar rregullat për njoftimin e të pandehurit, të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale (KPP).

15. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor, janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

16. Referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), Gjykata ka përcaktuar ndër vite, disa standarde në lidhje me gjykimin në mungesë sipas të cilave: a) i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm në procesin gjyqësor të kryer në ngarkim të tij; b) i pandehuri mund të heqë dorë vullnetarisht nga ushtrimi i kësaj të drejtë; c) i pandehuri duhet të jetë në dijeni për ekzistencën e një procesi gjyqësor në ngarkim të tij; ç) duhet të ekzistojnë instrumente paraprake ose riparuese për të shmangur procese në ngarkim të të pandehurit, ose për të siguruar një proces të ri dhe, nëpërmjet depozitimit të provave të reja, të drejtën e mbrojtjes që nuk ka qenë e mundur të ushtrohet personalisht në procesin e zhvilluar në mungesë, të përfunduar tashmë (shih vendimet nr.30, datë 17.6.2010, nr. 45, datë, më 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

17. Sipas praktikës së kësaj Gjykate si dhe të GJEDNJ-së, është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve, sipas Gjykatës, është detyrë e organeve kompetente. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë, kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin (*shih vendimet nr.30, datë 17.6.2010, nr. 45, datë, më 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata, gjithashtu, është shprehur se duhet të pranohet mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit vetëm nëse provohet se ata po veprojnë në bazë të porosisë që kanë marrë nga i pandehuri. Pra, lejohet zgjedhja e avokatit nga ana e familjarëve vetëm nëse këta të fundit shprehin vullnetin e të pandehurit për të hequr dorë nga pjesëmarrja në proces dhe jo të investohen me këtë zgjedhje nëse ata nuk kanë kontakte me të pandehurin, çka, është detyrë e organeve kompetente shtetërore. Në këtë mënyrë është rigoroz zbatimi i procedurave të njoftimit (*shih vendimet nr.30, datë 17.6.2010, nr. 45, datë, më 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Si konkluzion, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri duhet të ketë dijeni në se ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ky duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të. Gjykata ka arritur në këtë përfundim, për arsye se heqja dorë nënkupton një akt vullneti nga ana e të pandehurit, që siç është pranuar nga teoria e së drejtës penale, për të pasur një akt vullnetar, duhet të ketë në radhë të parë një proces të brendshëm të perceptimit të realitetit nga ana e të pandehurit dhe më pas një proces të brendshëm vendimmarrjeje prej tij (*shih vendimet nr.30, datë 17.6.2010; nr. 45, datë 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Veç sa me sipër, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ka miratuar Rezolutën (75) 11 “Për kriteret e gjyimit në mungesë të të akuzuarit”, duke u rekomanduar shteteve anëtare që të mbajnë parasysh 9 rregulla minimale: i) askush nuk duhet të gjykohet pa pasur një thirrje për



gjyq në kohë; (ii) kjo thirrje për gjyq duhet të ketë të sanksionuara edhe pasojat nëse i akuzuari nuk vjen në gjykim; (iii) kur gjykata vëren se edhe pse i akuzuari është njoftuar dhe nuk është paraqitur, ajo, nëse çmon se prania e tij në proces është e pazëvendësueshme ose beson se i akuzuari është penguar të paraqitet, duhet të vendosë shtyrjen e procesit; (iv) i akuzuari nuk duhet të gjykohet në mungesë, nëse është e mundur të transferohen procedimet te një shtet tjetër ose të aplikohet për ekstradim; (v) kur i akuzuari gjykohet në mungesë, provat duhet të merren në mënyrë të zakonshme dhe mbrojtja duhet të ketë të drejtë të ndërhyjë; (vi) një vendim gjykate, i dhënë në mungesë, duhet t'i njoftohet personit sipas rregullave për njoftimet dhe marrjes dijeni brenda afatit të parashikuar për apelim. Ky afat duhet të fillojë që nga dita e marrjes dijeni efektivisht të personit, përveçse kur ai qëllimisht i fshihet drejtësisë; (vii) çdo personi të gjykuar në mungesë, duhet t'i jepet e drejta për apelim, me çdo lloj mjeti ligjor që do t'i ishte dhënë sikur ai të ishte i pranishëm; (viii) për personin e gjykuar në mungesë, të cilit nuk i është bërë njoftimi në mënyrën e duhur, duhet të ketë një mjet ankimi që t'i mundësojë atij shfuqizimin e vendimit; (ix) një person i gjykuar në mungesë, por që njoftimi i është bërë në rregull, duhet të ketë të drejtën e një rigjykimi në mënyrën e zakonshme, nëse ai mund të provojë mungesën e tij para gjykatës për arsye të pavarura nga vullneti i tij.

21. Duke u bazuar në këto parime, edhe GJEDNJ-ja ka përcaktuar kritere të qarta dhe të plota për drejtësinë kushtetuese lidhur me gjykimin në mungesë. Ajo ka theksuar se e drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë (*Ektabani kundër Suedisë, 1988; Vaundelle kundër Francës, 2003*). Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur procedimet kanë natyrë kontradiktore. Shteti ka detyrimin për t'i dhënë të pandehurit një njoftim efektiv dhe të përshtatshëm për seancën dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij (*Poitrimol kundër Francës, 1993; Spinatto kundër HMP Brixton dhe Italisë, 2001*). Gjykata thekson se është e një rëndësie thelbësore, që i akuzuari të jetë i pranishëm në seancë, sepse ai ka të drejtën të dëgjohet, por edhe sepse ai ka nevojë t'i verifikojë gjykatës vërtetësinë e thënieve të tij dhe t'i krahasojë këto me të palës tjetër ose dhe të dëshmitarëve. Ligjvënësi duhet të jetë në gjendje të mos nxisë mungesa të pajustificueshme (*Geyseghem kundër Belgjikës, 1999*). Edhe pse nuk është absolute, e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, është një nga kriteret kryesore të gjykimit të drejtë. Një person i akuzuar penalisht nuk e humb këtë të drejtë thjesht për faktin se ai nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*Mariani kundër Francës, 2005*).

22. GJEDNJ-ja është shprehur gjithashtu se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. Njoftimi i paqartë dhe joformal nuk mjafton. Ndërkohë, nëse mund të pranohet një njoftim edhe tërthorazi, heqja dorë duhet të jetë e qartë. Është një e drejtë e personit të dënuar *in absentia*, i cili nuk rezulton se ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykim, të ketë në të gjitha rastet një vendim të ri mbi akuzat (*Sejdovic kundër Italisë, 2000*).

23. KEDNJ-ja u lë shteteve kontraktuese një diskrecion të gjerë lidhur me zgjedhjet e mjeteve, për të siguruar se sistemi i tyre ligjor është në përputhje me kërkesat e nenit 6 të saj. Detyra e GJEDNJ-së është të shqyrtojë nëse rezultati që KEDNJ-ja kërkon, është arritur nga shtetet kontraktuese. Veçanërisht, mjetet procedurale të ofruara nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se ato kanë qenë efektive, kur një person i akuzuar penalisht nuk ka hequr dorë nga të drejtat e tij për t'u dëgjuar dhe mbrojtur personalisht dhe as nuk i është fshehur drejtësisë (*shih vendimet nr.30, datë 17.6.2010; nr. 45, datë 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjithsesi, jo vetëm shkronja, por as dhe fryma e nenit 6 të KEDNJ-së nuk e ndalojnë një person të heqë dorë nga të drejtat e tij, me dëshirë shprehimisht ose taktikisht. Por, megjithatë, për

qëllimet e KEDNJ-së do konsiderohet efektive, që të drejtat e atij, që ka hequr dorë prej tyre, të sanksionohen pa ekuivoqe dhe të shoqërohen me një minimum të garancive, për shkak të rëndësisë së tyre. Autoritetet kombëtare kanë një marzh vlerësimi për zgjedhjen e mjeteve në sistemet e tyre ligjore, por me kusht që këto mjete juridike të jenë në përputhje me standardet e vendosura nga neni 6/1 i KEDNJ-së (*Colozza kundër Italisë, 1985*).

25. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja është shprehur se “ ... njoftimi i të akuzuarit në lidhje me akuzat në ngarkim të tij përbën një akt të një rëndësie të tillë, ku duhet të ekzistojnë elemente të formës dhe përmbajtjes që të garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtjes nga i akuzuari ... për rrjedhojë një njohuri e pasaktë dhe e marrë nga burime jozyrtare nuk është e mjaftueshme” (*Somogyi kundër Italisë, 18.5.2004*).

26. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata konstaton se në dosjen gjyqësore gjendet i administruar “Procesverbal për kërkimin e personit që nuk gjendet” i datave 23.4.2004 dhe 14.6.2004, sipas të cilit, edhe pas kontrollit të ushtruar në banesën e kërkuesit në lagjen “Liri”, rruga “Jakov Xoxa”, ky i fundit nuk u gjet, pasi ishte larguar jashtë shtetit pa adresë dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ndalohej dhe arrestohej. Në këto kushte, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr.65, datë 22.6.2004 ka vendosur deklarinimin e ikjes së kërkuesit dhe caktimin e mbrojtësit kryesisht, i cili është pajisur më pas nga babai i kërkuesit me prokurën e posaçme nr. 858 rep, nr. 251 kol, datë 19.4.2004, është njohur me aktet procedurale dhe ka kërkuar kohë për shqyrtimin e tyre. Pas deklarinimit të ikjes së kërkuesit, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në seancën e datës 3.2.2005, ka pranuar kërkesën e prokurorit dhe e ka deklaruar kërkuesin në mungesë duke i caktuar atij si mbrojtës atë të zgjedhur nga familjarët (babai) me prokurën e posaçme nr. 2766 kol, nr.813 rep, datë 19.10.2004. I njëjti mbrojtës ka përfaqësuar interesat ligjore të të pandehurit edhe në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda.

27. Gjithashtu, nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se, në periudhën kohore nga 29.10.2004 deri më 24.1.2005 Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka lëshuar shtatë “Urdhër mbi njoftimin e të pandehurve” drejtuar Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Fier. Nga shkresë-përgjigjet e Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Fier dhe nga raportet e shërbimit të Punonjësve të Policisë së Zonës (PPZ) rezulton se kërkuesi nuk gjendet në banesë dhe as në ambiente të tjera të frekuentuara më parë prej tij, por është larguar jashtë shtetit në Belgjikë, pa adresë. Ndërkohë, rezulton se fletë-thirrjet e gjykatës, drejtuar kërkuesit, janë marrë ose nga avokati i tij (fletë-thirrjet e datave 2.3.2004 dhe 12.7.2007) ose nga të afërmit e tij, konkretisht nga babai i tij (fletë-thirrjet e datave 1.12.2004, 4.7.2007, 12.7.2007) dhe xhaxhai (fletë-thirrja e datës 12.9.2007). Duke vlerësuar personat marrës të fletë-thirrjeve, si persona madhorë dhe me aftësi të dukshme intelektuale si dhe formën e përmbajtjes e fletë-thirrjeve, nuk rezulton se ka pasur ndonjë të metë që mund të bënte të pavlefshëm njoftimin në kuptim të neneve 140 dhe 143 të KPP-së.

28. Sa më lart, Gjykata çmon se organet shtetërore kanë marrë të gjitha masat dhe kanë kryer të gjitha veprimet e mundshme, duke përmbushur të gjitha detyrimet ligjore të parashikuara nga legjislacioni procedural penal si dhe nga KEDNJ-ja në lidhje me njoftimin personalisht të kërkuesit.

29. Nga analiza e fakteve të mësipërme, Gjykata arrin në konkluzionin se kërkuesi ka pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tij, por është larguar me vullnet të lirë nga Republika e Shqipërisë, duke zgjedhur, gjithashtu, me vullnet të lirë, të mos marrë pjesë në procesin penal në ngarkim të tij, me qëllim për t’iu fshehur drejtësisë.

30. Duke pasur parasysh se neni 33 i Kushtetutës sanksionon se nuk mund të përfitojë nga e drejta kushtetuese për t’u dëgjuar nga gjykata personi që i fshihet drejtësisë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të gjykimit në mungesë, është i pabazuar.



31. Si përfundim, Gjykata vlerëson se gjatë gjykimit të çështjes në ngarkim të kërkuesit Ismet Boriçi, nuk është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështirim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, pika “f” e 134, pika “g” të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës¹.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Petrit Pllloçi, Altina Xhoxhaj

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Admir Thanza

MENDIM PAKICE

1. Jemi kundër arsytimit të shumicës lidhur me pretendimin e kërkuesit për cenimin e të drejtës së mbrojtjes, për arsyet në vijim:

2. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës për t’u mbrojtur, si rrjedhojë e gjykimit në mungesë të tij, për shkak të mosrespektimit nga gjykatat të rregullave të Kodit të Procedurës Penale (KPP) për njoftimin e të pandehurit, është tërësisht në përputhje me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese, të shprehur në vendimin nr. 30, datë 17.06.2010.

3. Gjykata, me qëllim harmonizimin e jurisprudencës së saj me atë të GJEDNJ-së mbi gjykimin në mungesë, përmes interpretimit pajtues të nenit 410/1 të KPP-së, është shprehur se në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri duhet ketë dijeni në se ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në këtë kuptim, janë organet shtetërore ato që duhet të marrin të gjitha masat, nëpërmjet veprimeve aktive, për të siguruar gjykatën se i pandehuri është njoftuar në mënyrë të rregullt, se në ngarkim të tij ka një procedim penal dhe se i pandehuri, pas këtij njoftimi të rregullt, me vullnetin e tij të lirë vendos t’i fshihet drejtësisë. Në radhë të dytë, i pandehuri duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të (*shih vendimin nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në vlerësimin tonë, heqja dorë e të pandehurit vullnetarisht nga pjesëmarrja në procesin gjyqësor është e lidhur ngushtësisht dhe rrjedhojë logjike e njoftimit efektiv, pra përmbushjes në mënyrë efektive të detyrimit të autoriteteve për njoftimin e të pandehurit që nuk gjendet. Vetëm nëse autoritetet janë të sigurt se i pandehuri ka marrë njoftim në formën që parashikon ligji, atëherë mund të vazhdohet me procedimin e gjykimit të tij në mungesë. Në këtë proces, i gjykuari *in absentia*, gëzon të drejtën e mbrojtjes, e cila mund të garantohet edhe përmes zgjedhjes së avokatit nga ana e familjarëve, por me kushtin që këta të fundit të shprehin domosdoshmërisht vullnetin e të pandehurit, vullneti i cili gjen shprehjen e vet në tagrat që i jepen mbrojtësit. Nëse familjarët nuk kanë kontakte me të pandehurin, atëherë vullneti i tyre për zgjedhjen e mbrojtësit, pa qenë të autorizuar paraprakisht nga i pandehuri, nuk është i vlefshëm.

5. Gjykata, në referim edhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së, është shprehur se informimi i dikujt për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë që duhet

¹ Gjyqtarët P. Pllloçi dhe S. Berberi votuan pro rrëzimit të kërkesës por me arsytim paralel.

bërë në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të drejtave nga ana e të pandehurit. Njoftimi i paqartë dhe joformal nuk mjafton. Ndërkohë, nëse mund të pranohet një njoftim edhe tërthorazi, heqja dorë duhet të jetë e qartë. Është një e drejtë e personit të dënuar *in absentia*, i cili nuk rezulton se ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykim, të ketë, në të gjitha rastet, një vendim të ri mbi akuzat (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010 dhe nr. 45, datë 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Megjithatë, GJEDNJ-ja shprehet se nuk mund të përjashtojë mundësinë se i akuzuari ka dijeni për ekzistencën e procedimeve penale kundër tij, për natyrën dhe shkakun e akuzës, kur fakte të ndodhura/njohura përbëjnë tregues të padiskutueshëm të pasjes dijeni. Ky mund të jetë rasti, për shembull, kur i akuzuari deklaroi publikisht ose me shkrim se ai nuk do t'i përgjigjet thirrjeve për gjyq për të cilat ai ka marrë dijeni përmes burimeve të ndryshme dhe jo nga autoritetet, ose kur ai i shpëton një tentative arresti, ose kur materialet që sillen në vëmendje të autoriteteve, në mënyrë të padiskutueshme tregojnë se i akuzuari ka dijeni për procedimet ndaj tij dhe akuzat në ngarkim (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Shkalla kundër Shqipërisë, datë 10 gusht 2011*).

7. Në rastin konkret, shumica, ka arritur në përfundimin se kërkuesi ka pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tij, por është larguar me vullnet të lirë nga Republika e Shqipërisë, duke zgjedhur, gjithashtu, me vullnet të lirë, të mos marrë pjesë në procesin penal në ngarkim të tij, me qëllim për t'u fshehur drejtësisë. Në thelb, arsyetimin e saj shumica e ka mbështetur në faktin se organet shtetërore kanë marrë të gjitha masat dhe kanë kryer të gjitha veprimet e mundshme, duke përbushur të gjitha detyrimet ligjore të parashikuara nga legjislacioni procedural penal si dhe nga KEDNJ-ja në lidhje me njoftimin personalisht të kërkuesit.

8. Nuk jemi dakord në lidhje me argumentet mbi të cilët shumica ka vlerësuar përbushjen e detyrimeve që kanë autoritetet për njoftimin e të pandehurit që nuk gjendet dhe ka të dhëna se ai është jashtë shtetit, në referim të normave përkatëse të KPP-së të parashikuara në Kreun II, Njoftimet, nenet 132-143.

8.1 GJEDNJ-ja në lidhje me njoftimin e të gjykuarit në mungese, shprehet se dhe paraqitja e ankimeve nga mbrojtësi i zgjedhur nga babai i kërkuesit nuk nënkuptojnë se ky i fundit kishte dijeni efektivisht për procedimet kundër tij (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen "Shkalla kundër Shqipërisë", datë 10 gusht 2011, prg.72*). Shumica i ka vlerësuar të rregullta procedurat e njoftimit të kërkuesit dhe ka arritur në përfundimin se: *"duke vlerësuar personat marrës të fletë-thirrjeve (babai, xhaxhai, mbrojtësi me prokurë), si persona madhorë dhe me aftësi të dukshme intelektuale si dhe formën e përmbajtjen e fletë-thirrjeve, nuk rezulton se ka pasur ndonjë të metë që mund të bënte të pavlefshëm njoftimin në kuptim të neneve 140 dhe 143 të KPP-së"*.

8.2 Gjithashtu, shumica, në arsyetimin e saj pasqyron një fakt të rëndësishëm që rezulton nga materialet e administruara në dosjen gjyqësore, pikërisht largimin e kërkuesit jashtë shtetit, në Belgjikë, por pa adresë. Legjislacioni ynë procedural, në nenin 142 të KPP-së, parashikon se kur ka të dhëna të pamjaftueshme për të proceduar me dërgimin e letër rekomandesë me lajmërim marrje, si mënyrë për njoftimin e akuzës, autoriteti procedues, përpara se të nxjerrë vendimin e mosgjjetjes, urdhëron të bëhen kërkime edhe jashtë territorit të shtetit sipas rregullave të caktuara në marrëveshjet ndërkombëtare. Në këtë kuptim, duke e konsideruar mungesën e adresës së kërkuesit jashtë shtetit si të dhënë të pamjaftueshme, atëherë për autoritetet shtetërore lindte detyrimi për nxjerrjen e urdhrin për kërkimin e kërkuesit jashtë shtetit, megjithatë nga materialet e administruara në dosjen gjyqësore një urdhër i tillë mungon. Në këtë vështrim, vlerësojmë se, ndryshe nga sa arsyeton shumica, autoritetet shtetërore nuk i kanë përbushur të gjitha detyrimet ligjore në funksion të njoftimit efektiv të të pandehurit që gjendet jashtë shtetit. Në mungesë të një njoftimi zyrtar, kërkuesi nuk mund të konsiderohet se ka pasur mjaftueshmërisht dijeni për ndjekjen penale ndaj tij dhe për gjykimin aq sa ai ka hequr dorë nga e drejta për t'u paraqitur përpara gjykatës. Në përfundim të analizës së mësipërme, jemi të mendimit se shumica nuk ka marrë parasysh standardet e GJEDNJ-së mbi rregullat e njoftimit.



9. Në vështrim të sa më sipër, ndajmë mendim të ndryshëm me shumicën lidhur me kriteret që duhen zbatuar për verifikimin e dijenisë (vullnetit) së të pandehurit për të marrë pjesë në procesin penal në ngarkim të tij. Shumica ka arritur në konkluzionin se kërkuesi ka pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tij, por është larguar me vullnet të lirë nga Republika e Shqipërisë, duke zgjedhur, gjithashtu, me vullnet të lirë, të mos marrë pjesë në procesin penal në ngarkim të tij, me qëllim për t'iu fshehur drejtësisë. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh se neni 33 i Kushtetutës sanksionon se nuk mund të përfitojë nga e drejta kushtetuese për t'u dëgjuar nga gjykata personi që i fshihet drejtësisë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës për t'u mbrojtur, për shkak të gjykimit në mungesë, është i pabazuar (*paragrafët 29 dhe 30*).

10. Vlerësojmë se rregullimi kushtetues i parashikuar nga pika 2 e nenit 33 të Kushtetutës, që përcakton se personat që i fshihen drejtësisë humbasin të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata, nuk e kufizon tërësisht të drejtën e personit që i fshihet drejtësisë për të gëzuar mbrojtje efektive dhe të kualifikuar juridike. Vetë Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se përbën mohim të drejtësisë, kur një person i gjykuar në mungesë, nuk mund të arrijë që një gjykatë tjetër të shprehet përsëri në lidhje me akuzën, qoftë për sa i përket faktit, qoftë për sa i përket ligjshmërisë, pasi ta ketë dëgjuar, kur nuk përcaktohet në mënyrë të saktë që i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta që të paraqitet para gjykatës dhe të mbrohet ose që ka pasur qëllimin që t'i fshihet drejtësisë (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010 dhe nr. 45, datë 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. E drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë dhe kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur procedimet kanë natyrë kontradiktore. Gjykata thekson se është e një rëndësie thelbësore, që i akuzuari duhet të jetë i pranishëm në seancë, sepse ai ka të drejtën të dëgjohet, por edhe sepse ai ka nevojë t'i verifikojë gjykatës vërtetësinë e thënieve të tij dhe t'i krahasojë këto me të palës tjetër ose dhe të dëshmitarëve. Ligjvënësi duhet të jetë në gjendje të mos nxisë mungesa të pajustificueshme. Edhe pse nuk është absolute, e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, është një nga kriteret kryesore të gjykimit të drejtë. Një person i akuzuar penalisht nuk e humb këtë të drejtë thjesht për faktin se ai nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010 dhe nr. 45, datë 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në vështrim të standardeve të mësipërme, mendojmë se garantimi i të drejtës së mbrojtjes është kusht thelbësor për sigurimin e drejtësisë për çdo të pandehur, pavarësisht faktit nëse është i pranishëm apo gjykohet në mungesë. Të mos përfitosh nga e drejta kushtetuese për t'u dëgjuar nga gjykata, nuk nënkupton mohimin tërësisht të garancisë kushtetuese të mbrojtjes. Fryma e nenit 6 të KEDNJ-së nuk e ndalon një person të heqë dorë nga të drejtat e tij, me dëshirë, shprehimisht ose taktikisht, por megjithatë për qëllimet e Konventës do konsiderohet efektive, që të drejtat e atij, që ka hequr dorë prej tyre, të sanksionohen pa ekuivoke dhe të shoqërohen me një minimum të garancive, për shkak të rëndësisë së tyre (*shih vendimin nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Qëndrimi i mëparshëm i jurisprudencës së kësaj Gjykate dhe, për rrjedhojë edhe i gjykatave të zakonshme, që lejonte caktimin e mbrojtësit nga familjarët e të pandehurit edhe pa pasur pëlqimin ose autorizimin paraprak të tij, tashmë i korrigjuar, nuk duhet të pengojë kontrollin e respektimit të procesit të rregullt ligjor dhe garantimin e një gjykimi të ri të të pandehurit, pasi mendojmë se ky i fundit ka përparësi si e drejtë themelore e individit.

14. Përfundimisht, vlerësojmë se interpretimi i shumicës nuk është në funksion të drejtësisë efektive dhe dhënies kërkuesit të një sigurie të mjaftueshme dhe mundësisë për të pasur një gjykim të ri. Gjykata Kushtetuese, në referim të jurisprudencës së GJEDNJ-së për çështje të gjykimit *in*

absentia, duhet të jetë mjet efektiv në dispozicion të kërkuesit, me qëllim sigurimin e suksesit të mjeteve të përdorura.

Anëtarë: Vitore Tusha, Admir Thanza

MENDIM PARALEL

Në çështjen konkrete pajtohem me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, por kemi mendim të ndryshëm në lidhje me arsyet për këtë qëndrim, ndaj e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim paralel.

Në qëndrimin e saj për këtë çështje, shumica, pretendimit të kërkuesit se i është cenuar e drejta për t'u mbrojtur, pasi në gjykimin e zhvilluar në mungesë, ai është përfaqësuar nga mbrojtësi i zgjedhur prej të afërmeve pa pëlqimin e tij, i ka dhënë përgjigje duke vlerësuar se nuk mund të përfitojë nga e drejta kushtetuese për t'u dëgjuar nga gjykata personi që i fshihet drejtësisë, sipas nenit 33 të Kushtetutës, ndaj pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të gjykimit në mungesë, është i pabazuar. Shumica, në arsyetimin e saj, të drejtën për t'u mbrojtur të të pandehurit në mungesë e ka interpretuar në këndvështrimin e së drejtës për t'u dëgjuar, duke i lidhur integralisht këto dy të drejta në procesin e gjykimit në mungesë. Në vlerësojmë se këto dy të drejta qëndrojnë veçmas edhe në procesin e gjykimit në mungesë pavarësisht se bashkërisht janë parashikuar si garanci kushtetuese të procesit të rregullt ligjor. Në këtë çështje, sipas mendimit tonë, shtrohen këto probleme: A janë ndryshuar nga Gjykata në vitin 2010 standardet e vlerësimit të së drejtës së mbrojtjes të të gjykuarit në mungesë? Nëse po, a kanë këto standarde efekt prapaveprues dhe në këtë këndvështrim a ka detyrim Gjykata t'i zbatojë ato për çështje që janë gjykuar përpara vitit 2010, për të cilat vendimet kanë marrë formë të prerë? Nëse nuk ka detyrim të shprehur, mbi bazën e cilave kritere Gjykata do të vlerësojë, sipas rastit, të zbatojë ose jo standardet e reja për çështje që janë gjykuar mbi bazën e standardeve të mëparshme?

Siç është shprehur dhe shumica, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se e drejta e mbrojtjes, e parashikuar nga neni 31/ç i Kushtetutës merr një rëndësi të veçantë, sidomos në procesin penal. Kështu, gjatë këtij procesi kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas. Interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht (*shih vendimet nr. 40, datë 22.9.2011; nr. 30, datë 26.11.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Edhe pse nuk është absolute, e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, është një nga kriteret kryesore të gjykimit të drejtë. Një person i akuzuar penalisht nuk e humb këtë të drejtë thjesht për faktin se ai nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*shih vendimet nr. 23, datë 23.7.2009 dhe nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

Jurisprudenca e kësaj Gjykate në lidhje me gjykimin në mungesë të të pandehurit dhe garantimin e të drejtës së mbrojtjes, duke qenë aspekte shumë të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, ka evoluar, siç pasqyrohet në vijim.

Me vendimin nr. 17, datë 17.4.2000, Gjykata ka shfuqizuar vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë si antikushtetues, me arsyetimin, midis të tjerash, se “*e drejta e ankimit ndaj vendimit të gjykatës nuk është një e drejtë ekskluzive, që i takon vetëm të pandehurit, siç është e drejta për të pranuar ose jo veprën penale, për të bërë ose mos bërë deklarime etj. Sipas ligjit, e drejta e ankimit i takon edhe mbrojtësit si një nga kushtet për realizimin e plotë të mbrojtjes. Mbrojtësi i të pandehurit që gjykohet në mungesë, i caktuar sipas kërkesave të ligjit, gëzon të gjitha të drejtat e mbrojtësit në një mbrojtje të detyrueshme, përfshirë dhe të drejtën e ankimit ndaj*



vendimit të gjykatës”. Ky qëndrim i Gjykatës është rikonfirmuar edhe në vendimin nr. 5, datë 7.2.2001. Në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se moslejimi i mbrojtësit për të bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës të dhënë në mungesë të të akuzuarit në kushtet e nenit 410/2 të KPP-së e vë njëri palë në pozitë të pabarabartë me palën tjetër, duke cenuar parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit (shih vendimin nr. 15, datë 17.4.2003 të GJK-së). Në vështrim të vendimeve të mësipërme e sipas qëndrimit të konsoliduar të Gjykatës, mbrojtësi i të pandehurit që gjykohej në mungesë i caktuar nga familjarët, sipas kërkesave të ligjit, gëzonte të gjitha të drejtat e mbrojtësit në një mbrojtje të detyrueshme, përfshirë dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit të gjykatës.

Në vitin 2010, në dritën edhe të zhvillimeve të jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata ka riinterpretuar standardet e procedurës penale në lidhje me gjykimin në mungesë dhe sidomos në lidhje me të drejtën e mbrojtjes dhe të së drejtës për t'u rivendosur në afat për të ankimuar vendimin e dhënë. Përmes këtij interpretimi, Gjykata ka evidentuar këto standarde: e drejta e të pandehurit për të zgjedhur përfaqësuesit ligjorë është një e drejtë kushtetuese vetjake, e cila nuk mund të transferohet te familjarët; mundësia e familjarëve për të pajisur me prokurë mbrojtësin e të pandehurit nuk nënkupton transferimin e të drejtës për të zgjedhur mbrojtësin nga i pandehuri te familjarët, por nënkupton edhe ushtrimin e vullnetit të këtij të pandehuri, nëpërmjet familjarëve; në qoftë se ka mospërputhje ndërmjet vullnetit të të pandehurit dhe vullnetit të familjarëve të tij, që kanë keqinterpretuar vullnetin e të pandehurit ose kanë pasur një vullnet të ndryshëm për mbrojtësin ligjor, duhet të mbizotërojë vullneti i të pandehurit, i cili në çdo rast mund të refuzojë ose shkarkojë mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët (*shih vendimin 30, datë 17.6.2010*). Siç shihet qartë, pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës, në rastin e zgjedhjes së avokatit nga familjarët kanë ndryshuar standardet e vlerësimit të së drejtës së mbrojtjes në mungesë, e cila garantohet vetëm në kushtet e ekzistencës së vullnetit të të pandehurit që ushtrohet nëpërmjet familjarëve.

Nenet 124, 132 dhe 145/2 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë dhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues; ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet e GJK-së nr.14, datë 3.6.2009 dhe nr. 5, datë 7.2.2001*).

Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” evidenton tipologjinë e vendimeve që jep Gjykata, ku përfshihen vendimet e moskalimit, rrëzimit, pranimit, pezullimit, refuzimit, pushimit dhe ato interpretuese. Neni 76 i këtij ligji rregullon efektet juridike të vendimeve duke sanksionuar se vendimet e kësaj Gjykate që kanë shfuqizuar një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si rregull, sjellin efekte juridike nga data e hyrjes së tyre në fuqi. Si rregull përjashtimor, vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm: a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar; b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë; c) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar. Neni 79 parashikon se fuqi prapavepruese kanë edhe vendimet që bëjnë interpretimin e Kushtetutës. Pra, siç shihet, në vështrim të sa më sipër, as në Kushtetutë dhe as në ligjin organik të Gjykatës nuk parashikohet në mënyrë të shprehur nëse standardet e vendosura nga Gjykata nëpërmjet vendimeve interpretuese kanë efekt prapaveprues apo nëse Gjykata ka detyrim t'i zbatojë ato në mënyrë prapavepruese në lidhje me çështje të gjykuara për të cilat është marrë vendim i formës së prerë.

Gjykata, në vlerësimin e ligjit të zbatueshëm sipas rastit, në çështje konkrete, nëse është e mundur që një ligj apo normë ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë dhe vetëm njëra prej këtyre interpretimeve është në pajtim me Kushtetutën, zgjedh këtë të fundit. Kjo metodë kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve. Bazuar në këtë metodë interpretimi, Gjykata ka arritur në përfundimin se një ligj i kundërshtuar është kushtetues, me kusht që normat e tij të interpretohen në atë mënyrë siç ka bërë Gjykata në vendimin e saj (*shih vendimet nr. 29, datë 31.05.2010; nr. 33, datë 24.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjatë interpretimit të normës së kundërshtuar për Gjykatën ka më tepër rëndësi të mbrojtë ligjin se sa ta shfuqizojë atë, ose ta shfuqizojë ligjin pjesërisht se sa ta shfuqizojë tërësisht, jo për një favor legitimitatis, por sepse duke eliminuar tërësisht një akt legjislativ, që tërësisht ose pjesërisht mund të shpëtohet, evitohen boshllëqe normative të tilla që cenojnë interesa parësore të mbrojtura nga Kushtetuta.

Kur Gjykata ka riinterpretuar tekstin legjislativ të nenit 410/2 të KPP-së, të interpretuar më parë prej saj, duke nxjerrë nga ai një kuptim të ndryshëm të normës, ajo ka vlerësuar se nuk ekzistojnë të meta nga pikëpamja e ligjshmërisë kushtetuese.

Duke iu referuar çështjes konkrete, konstatohet se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka vendosur deklarinimin e ikjes së kërkuesit dhe caktimin e mbrojtësit kryesisht, i cili është pajisur nga babai i kërkuesit me prokurë të posaçme për të përfaqësuar interesat ligjore të kërkuesit. Kjo gjykatë ka pranuar si përfaqësues ligjor të kërkuesit mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët me prokurën e posaçme dhe ka vazhduar gjykimin e çështjes penale. Vendimi i dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është ankimuar nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët, që e kishte përfaqësuar kërkuesin gjatë gjykimit në shkallë të parë. Edhe ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është ushtruar rekurs nga mbrojtësi e të pandehurve, dhe nga dokumentacioni i dosjes gjyqësore rezulton se edhe në Gjykatën e Lartë interesat ligjore të të pandehurit janë përfaqësuar nga i njëjti mbrojtës i zgjedhur nga familjarët.

Ne vërejmë se procesi gjyqësor në ngarkim të kërkuesit është zhvilluar në periudhën kohore 2004 – 2009, periudhë në të cilën, bazuar në interpretimet e bëra nga jurisprudenca kushtetuese, mbrojtësi i caktuar nga familjarët e të pandehurit kishte të drejtën për të bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës të dhënë në mungesë të të akuzuarit, në kushtet e nenit 410, paragrafi 2 të KPP-së, duke siguruar kështu parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Kërkesa konkrete drejtuar Gjykatës me pretendimin, midis të tjerash, për cenimin e të drejtës së mbrojtjes, si një nga komponentët e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, është paraqitur pas datës 30.06.2010, e cila është data e hyrjes në fuqi të vendimit të ri interpretues, mbi bazën e të cilit janë përcaktuar standardet e reja dhe i është dhënë një kuptim i ndryshëm nenit 410/2 të KPP-së. Sipas standardeve të reja të vendosura nga Gjykata, mundësia e familjarëve për të pajisur me prokurë mbrojtësin e të pandehurit, nuk nënkupton transferimin e të drejtës për të zgjedhur mbrojtësin nga i pandehuri te familjarët, por nënkupton edhe ushtrimin e vullnetit të këtij të pandehuri, nëpërmjet familjarëve.

Në vlerësimin e faktit nëse vendimet riinterpretuese të Gjykatës, që përcaktojnë standarde të reja, kanë ose jo fuqi prapavepruese, ne çmojmë se Gjykata duhet të marrë në konsideratë një test balancues që konsiston në tri faktorë: a) qëllimi i rregullit të ri të përcaktuar si pasojë e interpretimit; b) mbështetjen e autoriteteve të zbatimit të ligjit mbi standardet e vjetra, në kuptimin e sigurisë juridike dhe, c) efektin që do të ketë fuqia prapavepruese në administrimin e drejtësisë.

Nisur nga faktorët e mësipërm, sjellim në vëmendje se, sipas jurisprudencës së Gjykatës, është e pranueshme, në mënyrë të natyrshme, që jurisprudenca kushtetuese të evoluojë, duke synuar zhvillimin e standardeve kushtetuese. Nga kjo pikëpamje, ekziston përherë mundësia që jurisprudenca, duke u plotësuar përmes konkluzioneve të reja interpretuese, edhe të ndryshohet, por Gjykata thekson se një ndryshim i praktikës mund të realizohet nëse ekzistojnë arsye të forta që do ta justifikojnë një ndërmarrje të tillë dhe vetëm në rastet kur kjo është e paevitueshme, objektivisht e



domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar (*shih vendimet nr. 20, datë 1.6.2011; nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Ne vlerësojmë se Gjykata, me rregullimin e ri, që ka të bëjë me mbrojtësin e të pandehurit në mungesë të zgjedhur nga familjarët, të përcaktuar nëpërmjet riinterpretimit, ka pasur si qëllim forcimin dhe rritjen e standardeve kushtetuese, në funksion të harmonizimit të koncepteve e garancive kushtetuese me praktikën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Për këtë rregullim të ri, vetë Gjykata është shprehur se “doktrina kushtetuese zyrtare në lidhje me përmbajtjen e neneve të mësipërme të KPP-së u riinterpretua në mënyrë të tillë që të ruajë sistemin e vlerave të sanksionuara në Kushtetutë, të forcojë garancitë mbrojtëse të epërsisë së saj në sistemin juridik, të zgjerojë garancitë e të drejtave dhe lirive të individit të sanksionuara në Kushtetutë në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar përgjithësisht” (*shih vendimin nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, me të drejtë, kanë pranuar mbrojtjen e interesave të kërkuesit, të deklaruar në mungesë, nga mbrojtësi i caktuar nga familjarët. Vendimet e këtyre gjykatave kanë qenë në përputhje me interpretimin që Gjykata i ka bërë përmbajtjes së nenit 410/2 të KPP-së, në lidhje me mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët, përmes vendimeve të saj interpretuese përpara viti 2010. Siç është përmendur edhe më sipër, këto vendime të Gjykatës kanë fuqi detyruese edhe për gjykatat të cilat e kanë detyrim kushtetues t'i zbatojnë ato. Gjatë kohës së zhvillimit të procesit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, sipas standardeve të vendosura nga Gjykata, mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët kishte të drejtë të përfaqësonte interesat ligjore të të pandehurit në mungesë dhe të ankimonte vendimet e gjykatave. Këto standarde të konsoliduara janë pranuar nga gjykatat e zakonshme dhe janë aplikuar në mënyrë konsekuente nga ato në të gjitha proceset ku mbrojtësi i të pandehurit në mungesë është zgjedhur nga familjarët. Në çështjen konkrete, proceset gjyqësore të zhvilluara në ngarkim të kërkuesit, nga gjykatat e krimeve të rënda dhe Gjykata e Lartë, tashmë kanë përfunduar dhe kanë prodhuar pasoja (dënimin e të pandehurit), të cilat janë ezauruar përpara hyrjes në fuqi të riinterpretimit të jurisprudencës kushtetuese në lidhje me gjykimin në mungesë dhe të drejtën e mbrojtjes.

Në vlerësimin tonë, zbatimi i standardeve të reja për çështje të gjykuara përpara evidentimit të këtyre standardeve nga Gjykata, dhe për të cilat vendimet kanë marrë formë të prerë, cenon parimin e sigurisë juridike, parim i cili është thelbësor për funksionimin e sistemit gjyqësor. Rihapja e proceseve penale me pasoja tashmë të ezauruara prej vitesh dhe ndryshimi i dënimeve të formës së prerë, do të eliminonte efektin penal parandalues që mbart në vetvete dënimi. Si pasojë, një aplikim prapaveprues i standardeve të reja procedurale penale që ka përcaktuar Gjykata në lidhje me zgjedhjen e mbrojtësit nga familjarët do të cenonte parimin e sigurisë juridike.

Edhe në aspektin e administrimit të drejtësisë, barra e cila do t'u ngarkojë autoritetet gjyqësore për të rigjykuar çështje të gjykuara më parë dhe shpenzimet gjyqësore do të ishin të konsiderueshme, pa lënë mënjanë edhe vështirësitë subjektive apo objektive të administrimit të provave gjatë procesit.

Në vështrim të arsyetimit të mësipërm, ne vlerësojmë se fuqia prapavepruese e vendimit të Gjykatës të vitit 2010 për sa i përket standardeve të vlerësimit të së drejtës së mbrojtjes të të gjykuarit në mungesë, të cilat ndryshojnë nga interpretimi i mëparshëm i Gjykatës me të njëjtin objekt, në rastin konkret, i shtrin kufijtë e saj natyrorë deri në paprekshmërinë e situatave dhe raporteve juridike tashmë të ezauruara në kohën që i paraprin interpretimit të ri. Kuptimi që kjo Gjykatë, përmes vendimit riinterpretues, i ka dhënë tekstit legjislativ të nenit 410/2 të KPP-së, nuk i shtrin efektet ndaj pasojave të ezauruara të proceseve gjyqësore të zhvilluara ndaj kërkuesit. Për pasojë, bazuar në argumentet e mësipërme, ne vlerësojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës së mbrojtjes është i pabazuar.

Anëtarë: Petrit Pllaçi, Sokol Berberi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 17.5.2012
Doli nga shtypi më 18.5.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 38 lekë